

FORMËSOJMË TË ARDHMEN

At the forefront

Group Report 2018 / SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

NE JEMI SIGAL UNIQA

NE jemi kompania lider në tregun e sigurimeve në Shqipëri, ku udhëheqim tregun vendas që prej vitit 2002, duke zotëruar mesatarisht 30% të tregut.

Grupi SIGAL UNIQA është një familje e madhe që numëron mbi 1500 punonjës dhe agjentë, të cilët u shërbejnë 1 milion klientëve në tre shtete: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

SIGAL UNIQA është ndër grupet më të mëdhenj financiarë në rajon, i përbërë nga 7 kompani sigurimesh dhe 1 fond pensioni privat dhe zotëron 121.2 milionë Euro asete, numëron mbi 65 milionë Euro prime të shkruara për vitin 2018 dhe rreth 300 milionë Euro dëme të paguara ndër vite.

Volumi i primeve (Euro)

Group	65,652,000
AL	39,649,000
KS	11,366,000
MK	14,637,000

Nr. i zyrave

Group	859
AL	398
KS	126
MK	335

Nr. i kontratave

Group	711,357
AL	433,049
KS	79,296
MK	199,012

Agjentë dhe punonjës

Group	1413
AL	725
KS	191
MK	497

PËRMBAJTJA CONTENT

FJALA PËRSHËNDETËSE	6	FOREWORDS	52
Z. Andreas BRANDSTETTER CEO i UNIQA Insurance Group		Mr. Andreas BRANDSTETTER CEO of UNIQA Insurance Group	
Z. Avni PONARI, CEO i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA		Mr. Avni PONARI, CEO of SIGAL UNIQA Group AUSTRIA	
KUSH JEMI NE?	10	WHO WE ARE?	56
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerat dhe parimet • Kush jemi SIGAL • Kush është UNIQA 		<ul style="list-style-type: none"> • Values and principles • We are SIGAL • Who is UNIQA? 	
PERFORMANCA NË 2018	13	PERFORMANCE IN 2018	59
<ul style="list-style-type: none"> • Ngjarjet kryesore 2018 • Media dhe marketingu • Përgjegjësia sociale në mjedis, sport, kulturë, edukim dhe punësim • Produktet dhe shërbimet e një vlere të shtuar • Dixhitalizimi dhe shërbimet e reja online 		<ul style="list-style-type: none"> • Highlights of 2018 • Media and Marketing • Social responsibilities in environment, sports, culture, education and employment • Products and services that add value • Digitalisation and other new online services 	
Tregu rajonal i sigurimeve	26	Regional Insurance Market	72
Raporti i audituesit të pavarur	29	Independent Auditor's Report	75
Raporti i Auditit të brendshëm	37	Internal Audit report	83
Parimet mernaxhimit të riskut	44	Risk assessment report	90
Objektivat	48	Forecast	94
Kontakte	95	Contacts	95

Të dashur lexues,

Për SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, Raporti Vjetor 2018-të është si një test financiar ADN-je. Ai është themeli ynë vizionar, strategjik dhe financiar. Një gur themeli i së shkuarës dhe një urë drejt së ardhmes. Ky është një raport llogaridhënës për aksionerët dhe partnerët tanë strategjikë. E gjithë energjia dhe përkushtimi ynë është në planet tona përparimtare të së ardhmes, në vitin 2019-të. Një e ardhme mjaft premtuese e cila do të jetë edhe më interesante për industrinë tonë, sesa viti që lamë pas, veçanërisht sepse ne jemi që të gjithë të përfshirë në kompleksitetin dhe shpejtësinë e ndryshimeve që na rrethojnë dhe që po bëhen gjithnjë edhe më të mëdha sesa kurrë më parë.

Unë dhe kolegët e mi të bordit menaxhues të grupit SIGAL UNIQA, i përkasim një gjenerate e cila në rininë e saj kishte më shumë kohë në dispozicion për të bërë projekte dhe plane afatgjata për 30-të apo 40-të vitet që do të vinin. Ku gjërat ishin ende shumë tradicionale, duke përdorur mënyra fikse të të menduarit dhe qasjes së fenomeneve që na rrethonin në jetët dhe në punët tona. Por në ditët e sotme, ky opsion nuk ekziston më, sepse ne jo vetëm që duhet të jemi vizionarë për 30-të apo 40-të vitet e ardhshme, por ne duhet të jemi absolutisht vizionarë për çdo 5-veçarë që ecën krahe nesh sepse ritmi i jetës dhe i ndryshimeve sot është ky. Që ne të mund të ruajmë shpejtësinë që po na dikton dita-ditës teknologjia e informacionit dhe e transformimit dixhital, ka impaktuar në mënyrë kapilare të gjithë metodat e punëve dhe të të bërit biznes duke e kthyer përmbys mënyrën e të punuarit.

Këto transformime rrënjësore kanë bërë që të gjithë ne, SIGAL UNIQA, partneri ynë strategjik UNIQA Insurance Group, investitorët, partnerët dhe klientët tanë, të bashkohen të gjithë në një vizion të përbashkët për të kapur “trenin tonë teknologjik” nëse duam që ai të na marrë me vete në të ardhmen. Sepse ne kemi mbi supë 1 milion klientët tanë besnikë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Po ashtu investitorët që besuan tek ne si drejtues të SIGAL UNIQA dhe tek punonjësit tanë të përkushtuar për t’ju çuar të gjithëve ju në të ardhmen tonë të përbashkët dixhitale të shekullit të XXI.


SIGAL UNIQA Group Austria



**Drejtoria e Përgjithshme
Tiranë, Shqipëri**

GRUP RAJONAL SIGURIMESH

Regional Insurance Group



FJALA PËRSHËNDETËSE

*Të nderuar zonja dhe zotërinj,
Të nderuar aksionerë,*

Me afrimin e vitit 2020-të, programi ynë strategjik afatgjatë, UNIQA 2.0, që ne jua kemi prezantuar në mes të vitit 2011-të, po i afrohet fundit. Viti i plotë dhe i parafundit financiarë për UNIQA 2.0 ishte 2018-ta, që ishte për ne një vit solid:

Së pari, ne jemi duke vëzhguar me kujdes nga afër themelet e forta që janë “Shtëpia jonë e përbashkët UNIQA”, p.sh., financat dhe pozicioni i kapitalit tonë. Shkalla e aftësisë paguese të kapitalit tonë mbetet, gjithashtu, krahasuar ndërkombëtarisht, në një përqindje të lartë prej 248%. Masat tona të brendshme edhe më të rrepta, shkalla e kapitalit ekonomik, është 205%, shumë më sipër sesa gama target e përcaktuar prej 190%. Si rezultat, UNIQA tani ka një tepriçë kapitali që kap shumë rreth 700 milion euro. Ne dëshirojmë që ta përdorim atë për të investuar në rritje fitimprurëse të qëndrueshme; rritja jo-organike do të ishte njëra nga mundësitë gjithashtu, por jo me çdo kosto. Për sa i takon primeve, qartësisht ne preferojmë një vjelje të optimizuar, të disiplinuar sesa një rritje të thjeshtë. Nëse nuk do të ishte i mundur investimi në rritje jo-organike sipas kushteve financiare të përshtatshme, ne do të paraqesim gjithashtu alternativa të tjera mbi shpërndarjen e fondeve gjatë prezantimit të strategjisë sonë të ardhshme për vitin 2021-një dhe më tej.

Së dyti, ne jemi duke përparuar lidhur me pesë nismat e Grupit tonë, të cilat formojnë “katin e parë” të “shtëpisë” sonë. Në 2018, ndryshimet e Grupit tonë në prime ishin më të mira nga sa prisnim, me një rritje të lehtë prej 0.3% në të treja linjat tona të biznesit (sigurimi i pasurisë dhe i aksidenteve, sigurimi i jetës dhe sigurimi i shëndetit). Rezultati teknik është gjithashtu më i lartë sesa vitin e shkuar. Arsyet për këtë janë disiplina jonë mbi menaxhimin e shpenzimeve dhe të sigurimeve, të karakterizuara nga një vit me nivele të ulta katastrofash natyrore. Shkalla jonë neto e kombinuar, një nga treguesit financiarë më të rëndësishëm, shënoi 96.8% dhe vazhdon të



Andreas Brandstetter
CEO i UNIQA Insurance Group AG

përmirësohet, rrjedhimisht, duke iu afruar kështu, objektivit tonë prej 95% deri në vitin 2020-të.

Me zhvillimin e fitimeve të kapitalit tonë sipas planit, përfshirë të ardhurat e jashtëzakonshme prej 47.4 milion euro nga shitja e pjesëmarrjes sonë në Kazinotë e Austrisë, fitimet tona neto pa përfshirë taksat janë rritur në 295-së milion euro. Një bonus tjetër i shtuar, është që kontributet e subvencionuesve tanë në Evropën Qëndrore dhe Lindore janë duke u rritur hap pas hapi, në përputhje me strategjinë tonë. Bazuar në arsyetimin tonë mbi diversifikimin, ne do të dëshironim që të zhvillojmë një çentral elektrik gjeografik të dytë, në vitet e ardhshme përveç subvencionuesit tonë austriak që ka një performancë teje të lartë. Me një shkallë taksash të aplikuara prej 20%, të ardhurat tona neto janë rritur në 243 milion euro. Për këtë arsye, në takimin tonë vjetor të përgjithshëm ne do të sugjerojmë që dividendët ndaj aksionerëve të rriten me 2% deri në 0.53 euro për aksioner. Si rezultat, shkalla e pagesës do të bie me përafërsisht 67%.

Së treti, ne jemi duke punuar intensivisht mbi optimizimin e investimit dhe të burimeve tona njerëzore, të cilat ndodhen në “katin e dytë” të “shtëpisë” sonë. Ky “kat” simbolizon të ardhmen e

industrisë sonë. Novacionet e lidhura me inteligjencën artificiale, robotikën, ofertat dixhitale për klientët tanë dhe modele të reja biznesi.

Jo vetëm që ne duhet t'i financojmë këto zhvillime me të ardhurat e gjeneruara nga biznesi ynë bazë, por këto janë zhvillime të cilat kërkojnë gjithashtu në mënyrë periodike dijet e vlefshme dhe kohën e punonjësve tanë në “katin e parë”. Megjithatë, nëse këta punonjës i përkushtojnë pjesën më të madhe të kohës së tyre punëve të përditshme ose plotësimit të kërkesave të grupit mbi IDD, GDPR ose IFRS 9/17, standardet e llogarive që do të lidhen nga 2022 do të vonohet në zbatimin e këtyre projekteve novatore, ose ato nuk do të mund të zbatohen plotësisht.

Kjo është arsyeja përse ne po kërkojmë që të optimizojmë portofolin e madh të projekteve tona, për të gjetur një përzjerje të mirë të produkteve duke adresuar kërkesat rregullatore, investimet e operacioneve të biznesit tonë, dhe projektet reale për të ardhmen. Kjo është diçka të cilën ne e ‘bëjmë fjalë për fjalë’ çdo ditë. Në këtë kontekst, ne u çuditëm kur Alexander Bockelmann, anëtari i Bordit Ekzekutiv të Grupit, i cili ishte përgjegjës për dixhitalizimin deri në fund të vitit 2019-të, u transferua tek një konkurrent ndërkombëtar zviceran. Por kjo tregon se, sfida me të cilën ne përballemi: nga njëra anë, kompania jonë promovon shumë punonjës të talentuar të jashtëzakonshëm nëpër të gjithë botën, por nga ana tjetër, ne duhet t'i ofrojmë atyre më shumë liri veprimi, si edhe opsione më të mira për zhvillimin e tyre personal. Ajo që më shqetëson më shumë, është çështja se si mund të zbatojmë dhe përmbushim të gjitha kërkesat rregullatore pa shumë përpjekje dhe shkëlqyeshëm, ndërsa jemi duke kryer punën tonë bazë me sa më pak përpjekje dhe shkëlqyeshëm që të jetë e mundur dhe të kemi ende, burimet që duhet të shpërndajmë për projektet tona novatore që janë në përfitim të klientëve tanë. Kjo më shqetëson gjithashtu, sepse, ndryshimi po ndodh shpejt dhe më shpejt, që do të thotë se, ne duhet të rrisim dukshëm shpejtësinë tonë, nëse do të duam në këtë epokë dixhitale, të mbetemi të rëndësishëm për klientët tanë.

Në vitin e plotë të fundit të UNIQA 2.0, programi jonë strategjik afatgjatë, ne jemi duke punuar intensivisht mbi tematikën: e ardhmja jonë. Ne do t'ju prezantojmë një variant të detajuar të këtyre planeve në mes të vitit

2020-të. Me moton tonë, “Hendeku i performancës”, në jemi duke punuar për të përmirësuar fitimin tonë, ROE-në tonë dhe aftësinë tonë për të paguar dividendët në mënyrë të qëndrueshme. E shprehur thjesht, shpenzimet e prodhimit dhe të shitjeve të produkteve tona, aktualisht, janë shumë të larta për shkak të investimeve të përsheptuara qëllimisht mbi ‘vitalitetin’ e ardhshëm të kompanisë sonë që filloi në vitin 2016.

Me 25.9%, shkalla jonë e shpenzimeve është sipër asaj të kolegëve tanë më të mirë në nivel global. Në dëshirojmë që, ta ulim atë në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme pa qenë nevoja që të marrim vendime të dobta lidhur me kurimet mbi investimet më të rëndësishme të së ardhmes.

Në të njëjtën kohë, ne jemi duke përdorur “Hendekun e mundësisë”, si një moto për të punuar kundrejt ofrimit të klientëve tanë të zgjidhjeve më novatore dhe më të rëndësishme për ta më shpejt, veçanërisht në fushën e kujdesit shëndetësor. Vizioni ynë është zhvillimi i një ofruesi të integruar shëndeti hap pas hapi.

Së fundmi, zonja dhe zotërinj, për të shtatin vit rradhazi do të doja të përsërisja synimin tonë për të vazhduar pagimin e një dividend për aksioner çdo vit mbi bazat e rritjes së vazhdueshme të të ardhurave, pozicionin e kapitalit tonë jashtëzakonisht të fortë dhe rrjedhjen e qëndrueshme të parave. Në të njëjtën kohë, do të dëshiroja t'ju falenderoja në emër të të gjithë punonjësve për interesin tuaj në kompaninë tonë ekzistuese dhe jashtëzakonisht të mirë pozicionuar.

Kolegët e mi nga Bordi i Menaxhimit dhe unë dëshirojmë të trajtojmë me optimizim sfidat që shtrihen përpara nesh dhe për të formësuar të ardhmen e kompanisë sonë me kujdes.

Ne vazhdojmë të jemi të kënaqur në çfarëdo gjëje që mund të bëjmë për të siguruar jo vetëm klientët tanë, por gjithashtu veçanërisht edhe ju, si aksioner, që të gëzoni një jetë më të sigurt, më të mirë dhe më të gjatë.

Andreas Brandstetter
CEO i UNIQA Insurance Group AG

FJALA PËRSHËNDETËSE

Të nderuar partnerë dhe klientë,

Viti 2018-të ishte një vit mjaft i mbarë dhe i suksesshëm për SIGAL UNIQA . Unë kam besimin e plotë se ne jemi duke ecur të sigurt në vizionin dhe hapat tona pararojë ,përmbi të gjithë konkurrentët tanë të shumtë në sektorin e sigurimeve, për të lënë pas mënyrat e vjetra të të bërit biznes dhe të strategjizimit tonë nëpërmjet modernizimit, evolucionit, revolucionit dhe inovacionit teknologjik, si edhe të proceseve dixhitalizuese e automatizuese të sigurimit online, me një paketë financiare solide, duke e udhëhequr kështu industrinë shqiptare të sigurimeve përpara në shekullin e XXI

Ky vit shënoi gjithashtu 19-të vjetorin e themelimit të SIGAL UNIQA në përmbyllje të afërt të rrugëtimit tonë prej thuajse dy dekadash të gjata, por të mbushura me arritje, suksese të parrokura më parë në mënyrën e të menduarit, planifikimit e modelit të biznesit në Shqipëri, në përgjithësi, dhe në industrinë e sigurimeve, në veçanti, por edhe me mjaft sfida dhe shtigje të reja. Sot në emër të të gjithë stafit, bordit të menaxherëve, partnerëve strategjikë dhe të agjentëve tanë të përkushtuar të zinxhirit të shitjeve, jam krenar dhe i lumtur të them se në rrugëtimit tonë të “Një mijë e një netëve të labirintëve të sukseseve dhe të sfidave”, frazën magjike të “Hapu Sezam”, e kemi bërë ne.

Ne ia kemi dalë gjithmonë dhe vazhdojmë të jemi në krye të operacioneve dhe aktiviteteve siguruese në vend ..Sepse ne ofrojmë shërbimet e cilësisë më të lartë ndaj klientëve dhe partnerëve tanë të biznesit; sepse ne kemi besimin dhe besnikërinë e klientëve dhe partnerëve tanë ,tek ajo që ne bëjmë dhe puna shumë serioze që ne bëjmë është tashmë mision edhe i vetë jetëve tona; sepse ne i konsiderojmë klientët dhe partnerët tanë të biznesit si të barabartë dhe aleat; sepse ne u përkushtojmë secilit prej tyre vëmendje individuale, korrekte dhe transparente ndaj nevojave të tyre të sigurimit; sepse ne jemi gjithmonë aty dhe kurdoherë ku klientët dhe partnerët tanë kanë nevojë për ne dhe ne tashmë që prej vitit 2015-të jemi vetëm një klikim larg sigurimit online për të gjithë.

Dhe sepse ne jo vetëm që duam të jemi më të mirët, por sepse ne duam që të jemi gjithmonë më të mirët; sepse ne jemi të paepur, që vazhdojmë të mësojmë dhe të rritemi në çdo hap që hedhim dhe këto janë arsyt që na bëjnë neve të themi që përtej asaj që kemi arritur, ne jemi ende në hapat tonë të parë; sepse idetë dhe vizioni ynë nuk ‘fle kurrë’ por vigjilon në tendencat më të fundit në industrinë e zhvillimit ,për t’u ofruar klientëve tanë standardet më të mira globale dhe ato evropiane; sepse ne dimë se si të zgjedhim stafin më të mirëpërgatitur në treg ,duke iu



Avni Ponari
CEO i SIGAL UNIQA Group Austria

dhënë mundësinë dhe mbështetjen në zhvillimin e tyre të mëtejshëm profesional dhe personal; sepse ne dimë të menaxhojmë talentet e reja ,duke i shkrirë ato së bashku me dijet e kapaciteteve tona gati 20-të vjeçare në treg; sepse tek ne e reja ngrihet sipër duke u mbështetur në themelet tona solide; sepse ne kemi lidhshmëri më të mirë; dhe sepse ne kemi energjinë dhe dashurinë për t’ia dalë në çdo gjë që bëjmë. Historia që ne kemi shkruar në industrinë e sigurimeve është një dëshmitare shumë e qartë për këtë.

Duke parë në të ardhmen tonë dhe të industrisë së sigurimeve, dixhitalizimi ka sjellë ndryshime dhe sfida transformuese për të gjitha llojet e industrive, në përgjithësi dhe për sektorin e sigurimeve, në veçanti. Ne jemi duke e bërë këtë duke shkrirë dhe gërshetuar bashkë evolucionin dhe revolucionin teknologjik që na rrethon e na prek drejtpërsëdrejti. Ne nuk jemi thjesht të mahnitur nga vorbulla e transformimit teknologjiko-dixhital, por që prej vitit 2016-të, së bashku me partnerin tonë strategjik të një prej grupeve më të fuqishme financiare në Austri dhe në Evropën Qëndrore dhe Lindore, gjigandit austriak të sigurimeve UNIQA Insurance Group, që ka lançuar një paketë financiare investimi prej 500 milionë eurosh për dixhitalizimin e të gjitha operacioneve tona deri në vitin 2025, ku ne marrim pjesë si SIGAL UNIQA njëherësh në Shqipëri, Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut.

Për sa më sipër, ne si SIGAL UNIQA në Shqipëri dhe më gjerë në rajon, i kemi paraprirë shfaqjes dhe ngritjes së një gjenerate të re konsumatorësh potencialë të cilët nuk kanë

njohur kurrë më parë një botë pa internet (ata që kanë lindur pas viteve ‘90-të) apo pa akses në telefona celularë të lidhur 24 orë / 7 –të ditë të javës me akses të plotë dhe aktivë në të gjitha rrjetet e mundshme dixhitale. Në këtë drejtim, statistikatat dhe matjet e tregut na tregojnë se, 50% e brezit të ri sapo hapin syte veprimi i parë që ata bëjnë është futja online në të gjitha platformat dixhitale që për ta është thjesht një klikim.

Të qenit pararojë në këtë industri kaq interesante dhe komplekse e cila nuk ‘fle’ kurrë është strategjizimi dhe planifikimi që ne jemi duke i paraprirë në përmbysjen e dinamikave tradicionale të biznesit, jo në një të ardhme, le të themi 20-30 -vjeçare, por tani, e ardhmja është në pragun e derës sonë dhe ne jemi gati ta mirëpresim atë.

Për ta arritur këtë, ne jemi duke dizenuar dhe zhvilluar paketa të shumëllojshme produktesh dhe shërbimesh për të gjitha klasat e sigurimeve, jo duke vepruar siç është bërë për vite me radhë ku – produkti zhvillohej së brendshmi dhe pastaj hidhej në treg,por ne jemi duke u diktuar në kohë rekord nga nevojat dhe pritshmëritë më të fundit të klientëve dhe partnerëve tanë. Kjo na bën që të themi me krenari se ne kemi potencial duke qenë të parët sepse qendra e vëmendjes sonë janë klientët dhe perspektiva që udhëheq vizionet tona është ‘nga jashtë brenda’, pra nga klienti tek kompania dhe jo anasjelltas si në ditët e vjetra.

Duke qenë novatorë në atë që ofrojmë dhe mbi mënyrën se si e ofrojmë bën që klientët dhe partnerët tanë të kenë besim dhe të jenë besnikë ndaj marrëdhënies sonë për të garantuar një të ardhme më të sigurtë, më të mirë, më të paqte dhe më të shëndetshme.

Edhe pse kryefjala jonë është teknologjia e informacionit dhe dixhitalizimi, duke i dhënë përparësi “trurit teknologjik” të gjeneratave të reja që tashmë që prej 2015-s kanë mundësinë të na gjejnë dhe aksesojnë online nga aplikacioni SIGAL UNIQA në celularët dhe kopjuterat e tyre, ne nuk mund të anashkalojmë në asnjë mënyrë nevojat e gjeneratave më të vjetra.Të cilat nuk e disponojnë këtë dije dhe aftësim teknologjik dhe që për rrjedhojë kërkojnë që të kenë një marrëdhënie të drejtpërdrejt me 8-të kompani sigurimesh jetë dhe jo-jetë dhe me një fond pensioni, me mbi 1,500 punonjës dhe agjentë, në mbi 900-të zyra, në tre shtete ku ne operojmë në Shqipëri, Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut. Ne vazhdojmë t’i këshillojmë ata ballë për ballë kurdoherë kur ata kanë nevojë për shërbimet tona. Sepse ne komunikojmë me të gjithë, i mbulojmë të gjithë dhe sepse ne jemi të interesuar dhe të angazhuar për të gjithë ju.

Ne vazhdojmë të ruajmë avantazhin tonë konkurrues duke qenë kompania lider më e madhe e më e besuar e tregut shqiptar të sigurimeve, ku zotërojmë 30% të këtij tregu. Proceset tona janë eficientë dhe efektive; ne kemi eliminuar nga mënyra jonë e të bërit biznes burokracitë e kota, kohën e humbur dhe më pak shpenzime për të gjithë. Ne e bëmë këtë duke hapur për herë të parë në Shqipëri të parën dhe të vetmen ‘Zyrë Asistence’ për të Dëmtuarit nga Aksidentet Automobilistike’, duke iu ofruar qytetarëve asistence ligjore në kohë reale duke u shkurtuar atyre kohën e burokracitë nëpër zyra dhe gjykata.

Ne jemi krenarë që jemi shndërruar në “SiguruesitTeknologjikë” të parë në tregun shqiptar të sigurimeve dhe kjo do të jetë trashëgimia jonë e së ardhmes.

Gjatë 2018-s ne kemi punuar intensivisht si një bashkëpunim i stafit teknik me atë të IT-së dhe të marketingut për të përmbyllur gjithashtu ri-zhvillimin e orientuar nga teknologjia dhe dixhitalizimin e të të gjitha produkteve dhe shërbimeve tona siguruese, që do të lançohen zyrtarisht online përgjatë 6-të mujorit të parë të vitit 2019-të, me prioritet kryesorë në theksin tonë ndaj rritjes së primeve në sigurimet vullnetare, përveç atyre të detyrueshme si sigurimin e pasurisë, të mikro bizneseve/ SME-ve, sigurimin e përgjegjësive publike, sigurimin e përgjegjësive profesionale – ato të detyrueshme sipas legjislacioni kombëtar në fuqi dhe atyre vullnetare – si farmacitet, dentistët, noterët, avokatët, inxhinierët dhe arkitektët, si edhe sigurimin e banesave dhe të hapësirave të përbashkëta në kuadër të ligjit të ri të administrimit të hapësirave të përbashkëta në komunitet.


Për më tepër, ne jemi duke lobuar me institucionet shqiptare dhe kompanitë e tjera të sigurimit për bërjen të detyrueshme të kontributit të njerëzve me ligj në pensionin privat. Dhe ne jemi duke e bërë këtë paralelisht nëpërmjet punës ndërgjegjësuese dhe informuese mbi kulturën, mentalitetin dhe praktikatat tona mbi pensionet private si e vetmja siguri dhe garanci e së ardhmes në pension.

Duke ju falenderuar përzemësisht të gjithëve ju për besimin që keni tek ne në thuajse dy dekada. “Sezamin” e sigurimeve e kemi hapur së bashku. Gjithashtu unë kam besimin e plotë në potencialin dhe në kapacitetin tonë për të rrugëtuar së bashku në një epokë të re nën frymën e mirë dhe pasionin e ekipit që unë drejtoj me krenari.


Miqësisht,

Avni PONARI
Drejtor i Përgjithshëm

Bordi Mbikëqyrës SIGAL UNIQA Group Austria



Aksionerët tanë



Andreas Brandstetter
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA
CEO i UNIQA Insurance Group



Erhard Busek
Zv. Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA



Wolfgang Kindl
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA
CEO i UNIQA International



Gerald Mueller
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA



Alexander Breit
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA



Vinzenz Benedikt
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA



Martin MATA
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA

PARIMET DHE VLERAT

Sot ne jetojmë në një botë shumëngjyrëshe e cila po ndryshon me një shpejtësi marramendëse. Ne që të gjithë e dimë se kemi ende shumë punë për të bërë për të arritur dhe për të përmbushur kërkesat e ofruesve evropian të shërbimeve financiare në një konkurrencë globale agresive të shekullit të XXI-të.

SIGAL UNIQA është shumë e rëndësishme për ne. Pak a shumë si misioni i jetës sonë. Sepse ne besojmë se është privilegj që të punosh për sigurimin e jetës, pasurisë dhe shëndetit të klientëve tanë në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut. Sepse puna jonë është nga njerëzit për njerëzit. Dhe sepse ne jemi të vendosur që të investojmë kohën dhe vitet që na kanë mbetur në këtë botë në diçka kuptimplotë për të ardhmen tonë të përbashkët. “Të rriten dhe që të përkasim” është ajo që u intereson njerëzve sipas kërkimeve motivacionale të kryera. SIGAL UNIQA është e angazhuar që të ofrojë pikërisht këtë.

Ne aspirojmë që klientët tanë t’i gëzohen një jete sa më të sigurt, të mirë dhe të gjatë duke i frymëzuar atyre besim tek SIGAL UNIQA nëpërmjet formësimit aktiv të së ardhmes së tyre me ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të menjëhershme, të cilësisë më të lartë si edhe duke përmbushur premtimet tona. Ne punojmë dhe luftojmë që të përmirësohemi çdo ditë, sepse jemi shumë serioz në punën tonë dhe i përmbushim angazhimet tona maksimalisht çdo ditë dhe ne e bëjmë këtë duke jetuar me të vëtetë në mënyrë të qëndrueshme në çdo aspekt.

FRYMËZUJMË

Ne i mundësojmë dhe ndihmojmë klientët tanë që të jetojnë një jetë më të sigurt, më të mirë dhe më të gjatë sepse ne jemi të interesuar tek njerëzit.

FORMËSOJMË TË ARDHMEN

Ne jemi novatorë pararojë në industrinë e sigurimeve dhe vazhdojmë të zhvillohemi duke adresuar në kohë rekord të gjitha ndryshimet e shpejta teknologjike, qytetare, demografike dhe ato sociale.

JEMI TË DREJTPËRDREJT

Ne jemi të saktë, të shpejtë, të ndershëm dhe të drejtpërdrejtë.

INVESTUJMË

Ne vazhdojmë të përmirësojmë strategjinë tonë të investimeve veçanërisht investimet e qëndrueshme që marrin në konsideratë objektivat e modelit “Njerëzit, Planeti dhe Përfitimi”.

NGJARJET KRYESORE 2018



Forumi Ndërkombëtar UNIQA

Me moton ‘Mendo që idetë e mëdha ndriçojnë rrugën’, ky forum mbledhi bashkë mbi 120 CEO dhe kryetarë bordesh nga 16 –të shtete të Evropës, në Tiranë. Më specifikisht, u diskutua mbi mbarëvajtjen, objektivat dhe synimet e Grupit UNIQA në të gjithë shtetet ku gjigandi evropian i sigurimeve operon, përfshirë edhe Shqipërinë nëpërmjet SIGAL UNIQA

Group Austria. Takimi u përshëndet edhe nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Z. Erion Veliaj i cili i uroi mirëseardhjen të ftuarëve duke u ndalur në potencialin e jashtëzakonshëm që ka Tirana dhe e gjithë Shqipëria, si edhe mbi rolin SIGAL UNIQA në zhvillimin ekonomik dhe përgjegjësinë sociale në Tiranë dhe më gjerë.



19 Vjet SIGAL

Me rastin e 19-të vjetorit të themelimit të SIGAL UNIQA u organizua një takim me stafin pranë ambienteve të Hotel Sky në Tiranë, ku Drejtori i Përgjithshëm, Z. Avni Ponari shpalsi programin e kompanisë përgjatë vitit 2018, që përkon me 20-të vjetorin e SIGAL UNIQA. Ky rast u kurorëzua me një pritje të madhe më 20 Shkurt 2018. Në të njëjtën ditë, u ndanë edhe çmimet e konkursit për idenë më të mirë për reklamën e sigurimit të shtëpisë online. Teksti i reklamës që fitoi çmimin e parë u realizua në reklamë, e cila u transmetua në pothuaj të gjitha kanalet televizive në Shqipëri. Me këtë rast të veçantë stafi i dhuroi Drejtorit të Përgjithshëm, Z. Ponari në shenjë falenderimi dhe mirënjohjeje një koleksion me vepra të vitit 1999



Bordi Drejtues i Grupi SIGAL UNIQA Shqipëri - Kosovë - Maqedoni

Analizat financiare të Grupit SIGAL UNIQA



Takimet e analizave 6-të dhe 8-të mujore si edhe Takimi Rajonal i Grupit të SIGAL UNIQA Shqipëri, Kosovë, dhe Maqedoninë e Veriut u organizuan në Mavrovë, Durrës dhe Tiranë. Me pjesëmarrjen e drejtuesve të kompanive, drejtorëve të departamenteve dhe menaxherëve të zyrave të SIGAL UNIQA nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut dhe të të gjithë drejtuesve të degëve dhe agjencive vendore. Kryefjala e këtyre takimeve ishin arritjet, objektivat, klienti, cilësia dhe korrektësia e shërbimit ndaj klientëve, dëmshpëblimet në kohë, sfidat e tregut shqiptar dhe atij rajonal, si dhe novacionet dhe investimet teknologjike ku u theksua

se SIGAL UNIQA është e vetmja kompani sigurimesh në Shqipëri që ofron sigurimin ONLINE me një klikim në www.sigal.com.al. SIGAL UNIQA që prej vitit 2002, udhëheq tregun e sigurimeve me mbi 35% të tregut ku operojnë 11-të kompani në tregun e Jetës dhe Jo-Jetës në Shqipëri. SIGAL UNIQA zotëron rreth 17% të tregut rajonal të sigurimeve, ndërkohë që renditet e para në tregun shqiptar (rreth 35%) dhe atë kosovar (rreth 16%). SIGAL UNIQA është e vetmja kompani e licensuar për të gjitha klasat e sigurimit, me 42 produkte në treg, pjesë e UNIQA Insurance Group, kompania lider në Evropën Qendrore dhe Lindore në fushën e sigurimeve dhe të investimeve.

CEO i SIGAL UNIQA Z. Ponari nderohet me çmimin “Justiniani i Madh”



Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria dhe njëherësh Konsull i Përgjithshëm Nderi i Japonisë, Z. Avni Ponari nderohet me çmimin “Justiniani i Madh” nga Akademia Monarkiste Shqiptare me motivacionin, “Për kontributet e shquara si Konsull i Përgjithshëm Nderi i Japonisë në Shqipëri (prej vitit 2009, në dy mandate) në zhvillimin e marrëdhënieve shumë të mira diplomatike, ekonomike e tregtare, kulturore; në shkëmbimin e ideve e kulturave; në promovimin e biznesit, turizmit, etj, në mes këtij vendi mik monarkist dhe Shqipërisë e Kosovës”.

SIGAL UNIQA organizon takimin e përbashkët e të gjitha grave dhe vajzave të reja të SIGAL UNIQA



SIGAL UNIQA organizoi më 8-të-10-të Mars, në Korfuz një takim të përbashkët me pjesëmarrjen e të gjitha grave dhe vajzave të reja të SIGAL UNIQA të cilat përbëjnë 50% të forcave të punës së kompanisë. Z. Ponari vlerësoi në mënyrë të veçantë punën dhe arritjet e shënuara nga punonjëset gra dhe vajza të reja pjesë e ekipit të madh të SIGAL UNIQA, të cilat përbëjnë thuhet 50% të kompanisë në pozicione të ndryshme si specialiste, menaxhere të nivelit të dytë dhe menaxhere të larta në krye të ekipit drejtues të kompanisë më të madhe dhe më të besuar të sigurimeve në tregun shqiptar. Për më tepër, ky është një tregues mbi prioritetin dhe mbështetjen e këtyre punonjësve nga SIGAL UNIQA për vlerën e tyre të shtuar në kompani.



Ne jemi renditur si Super Brand 2018 nga Super Brand.

Vlerësimet ndërkombëtare

SIGAL UNIQA u shpall “Biznesi më i mirë i vitit 2018” nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës, për përkushtimin ndaj klientëve, korrektësinë, dëmshpërblimin në kohë. SIGAL UNIQA është vlerësuar vazhdimisht nga organizma financiare shqiptare dhe ndërkombëtare me çmime për cilësinë, produktet novatore, korrektësinë ndaj klientëve, si biznesi më i mirë, lidhshipi më i mirë, si brandi më i besuar e shumë të tjera.

UNIQA - NJË PREJ KOMPANIVE MË TË MËDHA TË SIGURIMEVE NË EUROPE


UNIQA Insurance Group është prezente në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni që prej vitit 2007, si aksioneri kryesor i SIGAL UNIQA.

UNIQA është një prej grupeve më të fuqishëm financiarë në Austri dhe në Europën Qendrore dhe Lindore.


Gjigandi i sigurimeve ka një histori mbi 200-vjeçare në tregun e sigurimeve dhe përbëhet nga rreth 20 mijë punonjës që iu shërbejnë mbi 10 milionë klientëve në 16 shtete.

Me 21% të tregut, UNIQA është kompania e dytë më e madhe në Austri. Aktiviteti i grupit UNIQA është i shtrirë në 16 shtete të Europës Qendrore-Lindore, ku operon përmes 40 kompanive sigurimi.

% sipas produkteve



...në tregun në Austri
dhe Europën Qendrore dhe Lindore



Mendo



UNIQA Insurance Group
Vjenë, Austri

MEDIA DHE MARKETINGU

SIGAL UNIQA prezanton platformën e saj të re dixhitale www.sigal.com.al me pjesëmarrjen e Bordit të UNIQA Insurance Group, në Tiranë, pasqyruar në median vizive dhe atë të shkruar si Top Channel, Pressreader, etj.



SIGAL UNIQA organizon për herë të parë, Forumin Ndërkombëtar të Biznesit në Shqipëri, pasqyruar në Gazetën “Shqiptarja” dhe në Gazetën “Telegraf.”-

Publikimi i analizës së profiit të suksesshëm të SIGAL UNIQA dhe Drejtorit të Përgjithshëm, Z. Avni Ponari në katalogun “Biznesi Shqiptar: Më të mirët 2018”.



SIGAL UNIQA në bashkëpunim me Universitetin Europian të Tiranës prezantoi konkursin “INOVACIONI NE SIGURIME” me pjesëmarrjen e studentëve të këtij Universiteti për të kryer kërkime dhe propozimin e ideve të tyre novatore mbi tregun e sigurimeve në Shqipëri me synim njohjen dhe edukimin e brezave të rinj mbi tregun e sigurimeve;

Publikohet në Revistën “Monitor” analiza e Drejtorit të Përgjithshëm, Z. Avni Ponari për “Tregu i sigurimeve më i varfëri në Europë, ja si mund të nxitet.”;



Publikohet në Targaime.com intervista e Drejtorit të Përgjithshëm të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA mbi “Përmbytjet dhe Sigurimet në Shqipëri”.

Publikohet në TiranaTimes.Com analiza për t’a bërë pensionin privat një sigurim të detyrueshëm në Shqipëri sipas praktikave Evropiane si edhe si një parakusht i garantimit të një të ardhme të sigurt dhe të qetë gjatë moshës së tretë.



Z. Avni Ponari, Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, i ftuar në Kanalin e TV RTSH1 në emisionin “Përballë” për të diskutuar mbi sigurinë në rrugë, numrin e lartë të aksidenteve në rrugët e Shqipërisë, arsyet, çfarë duhet përmirësuar, etj;



Z. Avni Ponari, Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, i ftuar në 55news.al për të diskutuar mbi “Fondin e Kompensimit për tregun e sigurimeve në Shqipëri.”

SIGAL UNIQA në bashkëpunim me “Vespa Club Tirana” & “Vespa Club Bari” promovon Shqipërinë me maratonën “Giro Dei Tre Mari Albania” për të gjithë të apasionuarit e motorit Vespa me pjesëmarrjen e 250-të shtetasve nga e gjithë bota;



SIGAL UNIQA organizon në Qendrën Tregtare TEG – Fushatën “Shtëpiza SIGAL” për sigurimin e nxënësve dhe studentëve që u shtri në me reklama në TV-të kombëtare dhe ato lokale, në rrjetet dixhitale dhe në universitete;

Promovimi i produkteve dhe shërbimeve të SIGAL UNIQA në emisionin “E diela shqiptare” me fokus tek dëmet dhe pensioni privat;

Emisioni Check-In shkon në Kullën e UNIQA në Vjenë ku u prezantuan vlerat historike dhe kulturore të qytetit të Vjenës dhe në një vizitë të veçantë në Muzeun Etnologjik të Vjenës (Welt Museum Wien) ku ndodhen edhe armët e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Mbështesim projektet mjedisore

SIGAL UNIQA, 'Rotary Club Tirana West' dhe 'InnerWheel Tirana' i bashkohen nismës së Bashkisë Tiranë, duke mbjellë 40-të pemë ulliri në kuadër të nismës për mbjelljen e 2 milionë pemëve në Pyllin Orbital të Tiranës.



Mbështesim aktivitetet sportive

Zhvillohet në Gjilan me mbështetjen e SIGAL UNIQA - "Kupa e Pavarësisë" me pjesëmarrjen e katër skuadrave: KF "Intelektualët" nga Gjilani, KF Tirana, KF Tetova dhe KF Prishtina. Trofeu simbolik u fitua nga KF Tirana.

Mbështesim trashëgiminë kulturore

Në kuadër të vitit kulturor Austri-Shqipëri, hapet në Tiranë me mbështetjen e SIGAL UNIQA ekspozita "Monarkia Austro-Hungareze dhe Shqipëria: 1916-1918". U ekspozuan dokumente historike dhe imazhe fotografike të Shqipërisë dhe Monarkisë Austro-Hungareze gjatë viteve 1916-të-1918-të, të realizuara nga ushtarët dhe regjentët austriakë në kujtesë të marrëdhënieve ndërmjet dy popujve tanë.



Mbështesim artin dhe kulturën

Orkestra e Harqeve e 'Klubi i Artit dhe Kulturës' së SIGAL organizon Koncertin "Vienna Salutes Tirana", me pjesëmarrjen e "Wiener Konzerthaus", e cila mbledhi së bashku artistët më të mirë shqiptarë dhe austriakë; Takime dhe konsultime mbi projektin "Aftësia e Kufizuar nuk është Paaftësi" për të mundësuar shkëmbimin e informacionit, integritetin e politikave vendore si dhe fuqizimin social-ekonomik të mbi 150-të të rinjve me aftësi të kufizuar të qytetit të Durrësit; Promovimi i librave të autores Vangjeli Verori Mehmetaj; "Ballo Vjeneze" në kuadër të vitit kulturor Shqipëri-Austri me pjesëza nga të dyja kulturat ajo vjeneze dhe shqiptare; Koncerti "Festojmë për Gjergj Kastriotin" në Kepin e Rodonit në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut, me pjesë nga Opera "Bijtë e Skënderbeut", të kompozitorit Abdulla Grimci, suitë me këngë arbëreshe etj, nën udhëheqjen artistike të Z. Ermir Dizdari" Mjeshtër i Madh";



Festivali "Tinguj Kinemaje", ku luajti Sinfoneta e RTSH-së me pjesë të zgjedhura nga filmat shqiptar dhe të huaj; Konkursi për "Skulpturën SIGAL" me temë "Zhvillim, rritje dhe vijimësi";

Festivalin Ndërkombëtar "Takimet Muzikore të Dy Botëve"; Filmi "The Brave", mbështetur financiarisht nga investitorë shqiptarë me qëllim prezantimin e një imazhi të një Shqipërie tjetër;

Hapet ekspozita "Graviteti Magjik" sjell "Graviteti Magjik" i ilustrimit të veprave të Gogol-it, Shekspirit dhe të La Fontenin, nga Marc Chagall duke sjellë 180-të gravura dhe grafika të piktorit për herë të parë në Shqipëri me një përzgjedhje grafike të këtyre cikleve të tij më të njohura ilustrative;

Vjen në Shqipëri "Carta Nautica Uno", nga biblioteka e Romës me hartën e rrallë të Skënderbeut e vitit 1455-së; Festivali muzikor "Kënga Magjike 2018", me qëllim mbështetjen e artistëve të afirmuar dhe atyre të rinj.



Mbështesim edukimin dhe punësimin

SIGAL UNIQA zgjidhet nga dhjetëra studentë si një kompani model për studime; Vizitë e gjimnazistëve ekselentë të Tiranës në Drejtorinë e Përgjithshme në SIGAL UNIQA mbi rëndësinë e edukimit financiar të brezit të ri dhe prezantimit të koncepteve bazë të sigurimeve me fokus të rinjtë;

Në bashkëpunim me Universitetin Evropian të Tiranës u shpall konkursi për "Ide novatore për tregun e sigurimeve në Shqipëri";

"Forumi mbi sigurimet" me studentët e UBT në Prishtinë; Konferenca Kombëtare "Edukimi financiar" në fokus të së cilës ishin studentët të cilët u përfaqësuan me punime të ndryshme mbi sigurimet dhe pensionet private me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, nga kompanitë e sigurimeve dhe studentët të universiteteve të ndryshme;

SIGAL UNIQA pjesë në Panairin Kombëtar të Punës nën sloganin "Mendo skuadrën, ndërto të ardhmen", në Tiranë; Fushata e promovimit të sigurimit të nxënësve dhe studentëve në 11 -të shkolla të ndryshme 9-vjeçare në Tiranë për të diskutuar dhe informuar nga afër prindërit dhe nxënësit për domosdoshmërinë e sigurimit të nxënësve;


Rikonstruksioni i shkollës "Matosh Uka" në Fierzë; SIGAL UNIQA organizon leksion të hapur me studentë të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë me qëllim edukimin e brezave të rinj mbi tregun jo bankar, sigurimet, si mund të përfitojnë të rinjtë nga pajisja me sigurime por edhe duke studiuar për këtë fushë si një potencial i madh për punën në Shqipëri.



E ardhmja është Online!

Bota Dixhitale e SIGAL UNIQA

Askund nuk ka nevojë të ndryshojë më shpejt sesa në botën online. Objektivi ynë këtu është të investojmë për klientët tanë në teknologjitë dixhitale që ne besojmë se mund ta bëjnë shërbimin tonë më të shpejtë dhe më efikas. Kryerja e sondazheve të klientëve tanë dhe të qenit të vëmendshëm ndaj tendencave të reja të tregut janë pika fillestare. Një ekip dixhital pastaj zbaton këto tendenca të reja për nevojat e klientëve tanë.



Shumë njerëz na pyesin se si ne zhvillojmë dhe zbatojmë produkte të reja dixhitale. Është e lehtë. Ekspertët më të lartë nga të gjitha fushat e UNIQA-s mblidhen së bashku në grupet e punës si pjesë e asaj që ne e quajmë "Shpirti i Dizanjit" për të shtrirë këtë detyrë. Këto grupe pastaj u kërkohet të prodhojnë rezultate në baza javore. Një model shumë ambicioz me një shkallë të lartë suksesi.

Siguro Makinën Online
 Sigurimi i makinës (TPL, Karton Jeshil apo Polica Kufitare) është i detyrueshem për qarkullimin brenda apo jashtë Shqipërisë. Tek SIGAL UNIQA mund të blini online siguracionin e makinës këto sigurime vetëm në pak minuta.

Siguro Shtëpinë Online

Tashmë tek SIGAL UNIQA mund ta blini online brenda pak minutash dhe të kurseni kohë dhe para.

Zgjidhni një nga paketat e sigurimit të shtëpisë që ofron SIGAL UNIQA Group Austria.



Sigurimi i Shëndetit Online

Karta e sigurimit të shëndetit "SIGAL", është karta me çmim ekonomik, me të cilën nuk do të mendoheni dy herë për të vendosur për të shkuar në një spital privat, kur keni nevojë për shërbime mjekësore! Blije atë online në www.sigal.com.al

Client Online

Për të ditur nëse kërkesa juaj për rimbursim të shpenzimeve shëndetësore është duke u shqyrtuar apo është rimbursuar SIGAL ka krijuar portalin Client Online. Gjithashtu ju mund të shikoni mbulimet që të ofron sigurimi juaj i shëndetit.

Inovacion pa pushim – për një shërbim edhe më të mirë dhe më efektiv për klientët tanë.



PRODUKTET DHE SHËRBIMET TË NJË VLERE TË SHTUAR

Fokusi tek shëndeti

SIGAL UNIQA doli në treg me një produkt të ri të sigurimit të shëndetit “Karta Spitalore Hygeia” që mbulon: shpenzimet në rast sëmundjeje me/pa shtrim në spital; 2 Check UP-e në vit; 10-të vizita në vit me mjekë specialistë; vizitë për Gastroskopi, Kolonoskopi, Kolposkopi dhe Laringoskopi etj, për vetëm 110 –të euro në vit;

SIGAL UNIQA hap “Qendrën e Asistencës për të Dëmtuarit nga Aksidentet Automobilistike”, me qëllim mbrojtjen dhe ofrimin e asistencës ligjore ndaj qytetarëve nga zvarritjet e procedurave gjyqësore të dëmshpërblimeve në rast aksidenti;

SIGAL UNIQA doli në treg me një produkt të ri të sigurimit të shëndetit “Karta e Kujdesit Shëndetësor” në bashkëpunim me spitalin më të ri privat në Tiranë, “Spitalin Continental”, me të cilën klientët do të marrin shërbime shëndetësore bazike, të paktën një herë në vit, me tarifa të përballeshme prej 2,500 lekë në vit.

Klinika Lëvizëse Mjekësore

Në muajt Prill, Qershor, Korrik, dhe Tetor Klinika mjekësore dhe ekipi i mjekëve të SIGAL UNIQA shkuan me shërbim 3-ditor falas, për banorët e



Ne jemi aty për klientët tanë kudo ku ata kanë nevojë për ne!

Ne jemi fuqimisht të fokusuar dhe të angazhuar për t'i sjellë produktet dhe shërbimet tona përmes aksesit dixhital në kohë reale, sa më thjeshtë dhe me një klikim për të gjithë klientët tanë kudo ku ndodhen. Objektivi ynë është që të investojmë për klientët tanë në teknologjitë dixhitale për të cilat ne besojmë se do t'i bëjë shërbimet tona më të shpejta dhe më efikente. Për të arritur këtë ne jemi vigjilentë ndaj të gjitha tendencave potenciale të reja të tregut duke i garantuar klientëve tanë trampolinën teknologjike të së ardhmes. Ne punojmë me një ekip të dedikuar dixhital vetëm për këtë qëllim. Ata janë frontiera jonë drejt së ardhmes sonë të përbashkët dixhitale. Vizioni dhe modeli ynë përkon me ambicien tonë drejt suksesit. Ne kemi filluar që të shkelim në këtë rrugë të përbashkët duke prezantuar:


Siguracionin e shtëpisë online duke qenë të parët që futëm në treg blerjen online të këtij produkti;

ChatBot-Aplikacioni më i ri i SIGAL UNIQA për klientët në Facebook, një program robotik, i cili u përgjigjet në mënyrë automatike klientëve që shkruajnë në inbox-in e facebook-ut të SIGAL;

SIGAL UNIQA doli në treg me një ofertë të re duke kombinuar së bashku siguracionin e makinës me prim të plotë në këmbim të përfitimit falas të sigurimit të apartamentit;

SIGAL UNIQA lançon aplikacionin e ri online të dedikuar për sigurimet, ku qytetarët jo vetëm mund të marrin të gjitha informacionet që ju duhen për sigurimet dhe të blejnë online sigurimin që ju duhet, por në kohë reale mund të aplikojnë për dëmshpërblimin;

SIGAL UNIQA Group Austria mori pjesë në Forumin e Ballkanit Perëndimor “Festivali i Inovacionit Tiranë” organizuar nga “Dhoma Italiane e Tregtisë,” në bashkëpunim me “Avdantage Austria”, me fokus dixhitalizimi dhe inovacioni i kompanive të sapokrijura si dhe bizneseve me eksperiencë dhjetërvjeçare.




TREGU I SIGURIMEVE NË RAJON

SHQIPËRI


Tregu i sigurimeve jo-jetë

Tregu i sigurimeve të jo-jetës, në të cilin operojnë 8 kompani, u udhëhoq nga SIGAL UNIQA e cila zotëroi 26% të tregut. SIGAL UNIQA renditet gjithashtu e para edhe për pagesën e dëmeve duke paguar 20.02% të dëmeve.




Tregu i sigurimeve të jetës

Që prej disa vjetësh, në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani sigurimi. Edhe për vitin 2018 tregu u udhëhoq nga SIGAL Life UNIQA me 59.3% e cila ka paguar 57,25% të dëmeve të ndodhura në treg.



Tregu i pensioneve private


Gjatë vitit 2018, në tregun e pensioneve operuan 3 fonde pensionesh private. Fondi i Pensioneve SIGAL udhëhoqi tregun si për vlerën e aseteve neto (47.43%).



KOSOVË


Tregu i sigurimeve jo-jetë

Në tregun kosovar operojnë 12 kompani sigurimi ndër të cilat SIGAL UNIQA Kosova renditet e dyta me rreth 11.63% të tregut për volumin e primeve si dhe ka paguar 9.97% të dëmeve totale të tregut.



Tregu i sigurimeve të jetës


Në tregun kosovar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani ndër të cilat SIGAL Life UNIQA Kosova renditet e dyta me 29.02% të tregut për volumin e primeve dhe ka paguar 19.18% të dëmeve.



MAQEDONI


Tregu i sigurimeve jo-jetë

Në tregun maqedonas të sigurimeve të jo-jetës operojnë 11 kompani. UNIQA a.d. u rendit në vendin e katërt për nga volumi i primeve të shkruara (9%).



Tregu i sigurimeve të jetës


UNIQA Life renditet e katërta në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës (5%) në të cilin operojnë 5 kompani.



TË DHËNA FINANCIARE


Grupi SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Prime të shkruara për katër vitet e fundit (në euro)



Kompania	2015 (në Euro)	2016 (në Euro)	2017 (në Euro)	2018 (në Euro)
SIGAL UNIQA AL Jo-Jetë dhe Risigurime	26,826,453	29,193,000	29,664,042	32,247,000
SIGAL Life UNIQA AL	4,821,793	4,249,000	5,476,588	5,314,000
SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA	1,269,642	1,681,000	1,461,529	2,088,000
SIGAL UNIQA KS Jo-Jetë	12,482,576	10,501,000	9,559,338	10,509,000
SIGAL Life UNIQA KS	910,595	762,000	636,650	856,000
UNIQA MK Jo-Jetë	11,063,068	11,323,000	11,345,015	13,054,000
UNIQA Life MK	961,656	1,170,000	1,405,624	1,583,000
GRUPI	58,335,782	58,879,000	59,548,838	65,652,000

Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2018



Lloji i Produktit	AL (në Euro)	KS (në Euro)	MK (në Euro)	Grupi (në Euro)
Pasuri	9,462,886	1,910,317	3,510,293	14,883,496
Motorike	19,577,894	6,370,718	8,136,179	34,084,791
Jetë, Shëndet dhe Aksidente	8,097,413	3,084,535	2,990,861	14,172,809
Pensione Vullnetare*	2,088,297	-	-	2,088,297
Risigurime*	422,957	-	-	422,957
TOTALI	39,649,448	11,365,569	14,637,333	65,652,350

* Produktet e Pensioneve vullnetare dhe Risigurimet ofrohen vetëm në Shqipëri përkatësisht nga kompanitë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Risigurime dhe SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA.

RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

Independent Auditor's Report

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara sipas
Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

*Consolidated Financial Statements
as at and for the year ended 31 December 2018*

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Bordin e Drejtorëve dhe drejtimin e Sigal Uniqa Group Austria sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare e konsoliduara të Sigal Uniqa Group Austria sh.a. dhe të filialeve të saja ("Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të konsoliduar të Grupit më 31 dhjetor 2018, si dhe të performancës së tij financiare të konsoliduar dhe flukseve të parasë të konsoliduar së tij për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara.

Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionin që jepet në raportin vjetor të përgatitur nga drejtimi në përputhje me Nenin 128 të Ligjit nr. 52 " Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve", dhe përfshijnë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Raportin vjetor presim që ta kemi në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare të konsoliduara, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur t'i sigurojmë ato dhe të konsiderojmë nëse këto informacione të tjera kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare të konsoliduara, apo me njohuritë që ne kemi marrë gjatë auditimit, ose nëse duket se ato kanë anomali materiale.

Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se në këtë raport ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimin dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, ofhtë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, për të dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për të përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.


Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Grupit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Grupit për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Grupi të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Fatos Beqja
Auditues Ligjor



KPMG Albania Shpk
Blvd "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 31 maj 2019

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVET			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	9	375,496	465,103
Depozita me afat	10	7,712,143	7,684,824
Investime në letra me vlerë	11	1,700,263	1,880,963
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të arkëtueshme të tjera	12	1,485,371	1,215,850
Llogarit të arkëtueshme të risigurimit	13	1,329,942	1,361,828
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	14	718,329	694,670
Aktive afatgjata materiale	15	1,165,181	1,192,559
Tatim fitimi i arkëtueshëm		59,235	38,627
Aktive të tjera	16	250,053	273,438
TOTALI AKTIVEVE		14,796,013	14,807,862
DETYRIMET			
Detyrimet për humbje dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	17	4,401,087	4,501,135
Rezerva të tjera	17	1,239,958	1,151,840
Rezervat për primin e pafitur	17	3,938,128	3,775,538
Detyrime të tatimit mbi fitimin		3,436	-
Detyrime nga sigurimet dhe risigurimet	19	578,942	651,358
Detyrime të tjera	20	352,642	311,473
TOTAL I DETYRIMEVE		10,514,193	10,391,344
KAPITALI			
Kapitali themeltar	21	2,232,909	2,232,909
Rezerva të tjera të kapitalit		52,133	52,133
Rezerva të rrezikut të sigurimit	22	581,774	579,595
Rezerva të konvertimit		(178,148)	(9,406)
Fitime të mbartura		1,573,208	1,546,380
Totali i kapitalit që i atribuohet pronarëve të shoqërisë mëmë		4,261,876	4,401,611
Interesi jo-kontrollues		19,944	14,907
TOTALI KAPITALIT		4,281,820	4,416,518
TOTALI KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		14,796,013	14,807,862

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë aprovuar nga drejtuesit e grupit më 31 maj 2019 dhe janë firmosur nga:


Arni Ponar
Drejtor i Përgjithshëm




Klement Mersini
Drejtor Finance

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.**Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***((Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek))*

	Kapitali themeltar	Rezerva të tjera të kapitalit	Rezerva të rrezikut të sigurimit	Rezerva të konvertimit	Fitime të mbartura	Të atribueshme për pronarët e shoqërisë mëmë	Interesi jo-kontrollues	Totali
Gjendja më 1 janar 2017	2,232,909	52,133	568,313	32,294	1,342,372	4,228,021	10,402	4,238,423
Fitimi i vitit	-	-	-	-	380,290	380,290	4,523	384,813
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksat	-	-	-	(41,700)	-	(41,700)	(18)	(41,718)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	(41,700)	380,290	338,590	4,505	343,095
Përvetësimi i fitimeve të mbartura	-	-	11,282	-	(11,282)	-	-	-
Dividendi i paguar	-	-	-	-	(165,000)	(165,000)	-	(165,000)
Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek pronarët	-	-	11,282	-	(176,282)	(165,000)	-	(165,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	2,232,909	52,133	579,595	(9,406)	1,546,380	4,401,611	14,907	4,416,518
Fitimi i vitit	-	-	-	-	190,007	190,007	5,004	195,011
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksat	-	-	-	(168,742)	-	(168,742)	33	(168,709)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	(168,742)	190,007	21,265	5,037	26,302
Përvetësimi i fitimeve të mbartura	-	-	2,179	-	(2,179)	-	-	-
Dividendi i paguar	-	-	-	-	(161,000)	(161,000)	-	(161,000)
Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek pronarët	-	-	2,179	-	(163,179)	(161,000)	-	(161,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,232,909	52,133	581,774	(178,148)	1,573,208	4,261,876	19,944	4,281,820

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.**Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Prime të shkruara bruto	23	8,108,503	7,814,415
Prime të ceduara në risigurim	24	(1,078,913)	(993,326)
Prime bruto të fituara		7,029,590	6,821,089
Ndryshimi në rezervën për prime të papërfituara		(270,805)	47,430
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituara	13	(17,985)	(121,359)
Të ardhura neto nga primet		6,740,800	6,747,160
Të ardhura nga investimet	25	148,308	127,239
Të ardhura të tjera	26	227,445	149,434
		7,116,553	7,023,833
Ndryshimi në rezerva të tjera		(114,828)	(143,181)
Ndryshimi në pjesëmarrjen e risigurimit në rezervën e dëmeve		(3,521)	418,694
Dëme dhe shpenzime nga rregullimi i humbjeve	17	(2,549,052)	(2,659,182)
Dëme të sigurimit neto		(2,667,401)	(2,383,669)
Kostot e marrjes në sigurim	27	(1,312,710)	(1,501,023)
Shpenzime administrative dhe marketingu	28	(1,959,811)	(1,711,053)
Shpenzime të tjera sigurimi	29	(439,076)	(404,920)
Shpenzime zhvlerësimi i të arketueshme nga sigurimi		(184,891)	(274,266)
Fitim nga kurset e këmbimit		(187,889)	(150,299)
Fitimi para tatimit		364,774	598,603
Tatimi mbi fitimin	30	(169,763)	(213,790)
Fitimi i vitit		195,011	384,813
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Zërat që janë ose mund të riklasifikohen më pas në fitim ose humbje			
Operacionet e huaja - diferencat në konvertimet në valutë të huaj		(168,709)	(41,718)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		26,302	343,095
Fitimi i atribueshëm për:			
Pronarët e shoqërisë mëmë		190,007	380,290
Interesi jo-kontrollues		5,004	4,523
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të atribueshme për:			
Pronarët e shoqërisë mëmë		21,265	338,590
Interesi jo-kontrollues		5,037	4,505

PËRMBLEDHJE E KONTROLLIT TË BRENDSHËM SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA 2018

Departamenti i Kontrollit gjatë vitit 2018-të ka parë e kontrolluar ecurinë e punës së bërë nga Sigal Uniqa Group Austria, në të gjithë departamentet e saj, gjatë veprimtarisë ekonomike e financiare në fushën e sigurimeve. Në këtë raport kontrolli do të paraqesim të dhënat e treguesit të realizuar nga kompania, rezultatet e saj dhe opinionet tona për përmirësimin në të ardhmen.

Departamenti i Pasurisë. Në këtë departament gjatë vitit 2018-të është punuar mirë. Pothuaj të gjithë llojet e sigurimit për këtë departament janë me rritje krahasuar me vitin 2017-të.

Në departamentin e pasurisë, vërejmë që shpenzimet për dëmet nuk janë në nivelin që mund të bëhen shqetësuese për kompaninë por në nivele normale. Kjo ka ardhur edhe si pasojë e një menaxhimi të mirë të rreziqeve nga sigurimi nga ana e departamentit. Dihet që gjithnjë marrja në sigurim, sidomos në sektorin e pasurive përmban në vetvete rreziqe të mëdha. Për këtë arsye nga departamenti ndiqen në mënyrë rigoroz rregullat e marrjes në sigurim të kompanive, kryesisht ato me rreziqe më të mëdha. Prandaj në këtë drejtim janë marrë masa si:

- Gjithnjë Çmimet vendosen përveçse shumës së marrë në sigurim, por edhe përvojës së akumuluar nga vitet e kaluara ,si dhe nga disa faktorë të tjerë.

- Janë zbatuar rregulla të rrepta duke mos lejuar asnjë lëshim në kriteret e vendosura për marrjen në sigurim.

- Studimi dhe njohja me aktivitetin e kompanisë së marrë në sigurim deri në detaje.

- Risigurimi i vlerës nga partnerë të sigurt e me përvojë në të gjitha rastet e një risku të lartë.

- Per Çdo vit janë bërë llogaritje të sakta të rezervave të domosdoshme për këto sigurime.

Të gjithë këta elementë, kanë bërë që për departamentin e pasurisë, kompania të mos ketë disbalanca apo gjendje të pasigurisë për të ardhmen.

Regjistrat e shitjeve mbahen të rregullt dhe konform udhëzimeve të dërguara nga Autoriteti Mbikqyrës Financiar. Këto rakordojnë për Çdo muaj me statistikën dhe departamentin e financës.

Per Çdo rast sigurimi janë mbajtur evidenca të sakta ,për rastet e personave të cilët janë të ekspozuar sipas udhëzimeve të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, duke bërë edhe njoftimet përkatëse për këtë qëllim në rastet që duhen.

Nisja e blerjeve të produktit “sigurim banese” direkt nga klientët nga aparatet e tyre është një punë e mirë e me perspektivë për të ardhmen.

Detyrë i lihet departamentit për rastet e rinovimit të kontratave të sigurimit të pasurisë, të bëhen më shpejt e brenda afateve, si dhe plotësimi i dosjeve të marrjes në sigurim me të gjithë dokumentacionin e kërkuar të marrjes në sigurim,pasi ka raste vonesash.

Departamenti Motorrik. Realizimi i të ardhurave për departamentin motorrik ka patur ecuri të mirë gjatë vitit 2018-të. Edhe departamenti motorrik ka mbajtur në mënyrë të rregullt regjistrat e shitjes së produkteve të tij të sigurimit duke zbatuar rregullat e Autoritetit Mbikqyrës Financiar. Rakordimet me statistikën dhe me departamentin e financës janë të sakta.

Bazuar në urdhrat e udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme për produktet tpl dhe karton jeshil ,ka filluar edhe blerja e tyre në sistemin on-line direkt nga aparatet elektronike të klientëve, punë kjo mjaft e mirë dhe me perspektivë për të ardhmen.

Departamenti I Shëndetit. Ka mosrealizime në primet e vitit 2018 –të krahasuar me vitin 2017-të. Kjo shumë vjen nga mosrealizimi për të gjithë produktet e sigurimit të këtij departamenti.

Mendojmë se duhet të merret në analizë ky produkt, duke parë mundësitë e uljes së shpenzimeve kryesisht për dëmet e paguara, komisionet e agentëve etj., apo mundësia e rritjes së primeve të sigurimit në mënyrë që edhe ky produkt të rezultojë rentable.

Regjistrat e shitjeve të bëra hidhen në rregull, këto rakordojnë me statistikën dhe departamentin

e financës dhe janë mbajtur konform udhëzimeve të Autoritetit Mbikqyrës Financiar. Edhe në departamentin e shëndetit është futur sistemi i blerjeve on-line nga vetë klientët me mjetet e tyre elektronike nëpërmjet kartave bankare, si për shëndetin në udhëtim, shëndetin privat etj, konform udhëzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme.

Për periudhën në vazhdim ,detyrë e lënë nga ana e departamentit tonë është rishikimi për të gjithë produktet për rritjen e efektivitetit ekonomik të tyre, duke marrë në analizë të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e kryera.

Në drejtim të zbatimit të detyrave të vendosura nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Autoriteti Mbikqyrës Financiar, është punuar mirë, evidentohen rastet e duhura dhe bëhet raportimi përkatës kur klientë të veçantë janë objekt i këtij investigimi.

Departamenti I Marinës e Aviacionit. Krahasuar me vitin 2017-të ka mosrealizim të të ardhurave nga sigurimet, e cila vjen në produktet “sigurim avione” dhe “anije (P&I).

Mendojmë që për përmirësimin e efektivitetit ekonomik në departament të shihen Çmimet e marrjes në sigurim, në rritje për produktin “sigurim malli në transport” dhe shpenzimet në produktin “Sigurim Avione.”

Për rrezikun nga sigurimet në produktet e departamentit të marinës, janë marrë masa në vazhdimësi dhe trajtimi i tyre është i njëjtë dhe vlejné ato që ne kemi përshkruar në departamentin e pasurisë.

Departamenti i Dëmeve. Organizimi i punës për dëmet e ndodhura në Sigal Uniqa Group Austria është bërë në mënyrë të tillë: departamenti i pasurisë ka një sektor me punonjës të veçantë, të cilët merren me dëmet e ndodhura në këtë departament, po kështu edhe departamenti i shëndetit ka sektorin e tij, i cili llogarit dhe dërgon për pagesë të gjithë dëmet në departament. Për dëmet tpl, kasko dhe minikasko funksionojnë dy departamente të ndarë : departamenti për dëmet e ndodhura për produktet tpl dhe minikasko dhe departamenti për dëmet kasko. Më vete funksionon edhe departamenti për llogaritjet e dëmeve të shkaktuara nga sigurimet karton jeshil ,si dhe dëmet të cilat kanë të bëjnë me fondin e kompensimit në marrdhënie me Byronë Shqiptare të sigurimit. Departamenti i marinës i trajton vetë dëmet e ndodhura me specialistët e tij.

Në departamentin e pasurisë kanë ndodhur e janë paguar për vitin 2018 –të dëme në shumën 57.547.141 lekë, shumë e cila është në shifra normale, pra që nuk ka patur dëme në vlera të mëdha apo në raste të paparashikuara për kompaninë.

Për të gjithë rastet e dëmeve, është hapur dosje e veçantë e cila përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në rastet e një dëmi konform udhëzimeve të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme dhe në pajtim me kushtet e kërkuara nga ana e Autoritetit Mbikqyrës Financiar. Bëhet inspektimi i plotë i rastit të dëmit të ndodhur, fotografimi i tij dhe plotësimi me formularët e kërkuar. Me tej dërgohet në departamentin e financës për pagesë. Në të gjitha rastet urdhri i pagesës firmoset nga Drejtori i Përgjithshëm. Rastet me dyshime apo jo në kushtet e kontratës janë dërguar në departamentin ligjor për ndjekje të mëtejshme të procedurave juridike.

Departamenti i shëndetit ka paguar për vitin 2018-të për dëmet e trajtuara nga ana e tij shumën prej 222.861.595 lekë, ku vlen të theksohet se vetëm për produktin e sigurimit “shëndet privat” janë paguar 189.598.302 lekë, që siç edhe e kemi trajtuar më sipër në këtë material zë një shumë të konsiderueshme në totalin e primeve të realizuara.

Edhe për departamentin e shëndetit, dosjet e dëmeve mbahen të veçanta për secilin person të siguruar, e të trajtuar me shpenzime dëmi shëndetësor, aksidenti e dëmi i shëndetit në udhëtim. Ato janë të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe faturat përkatëse të shpenzimeve. Ndiqet në mënyrë të rregullt trajtimi i të siguruarve si në spitalet brenda vendit dhe ato jashtë vendit. Për të gjitha shpenzimet e kryera mbahen regjistra të rregullt.

Departamenti I dëmeve tpl-miniskasko gjate vitit 2018-të ka berë pagesa në shumën 619.077.013 lekë ose e barabarte me 33,6 % të primeve të realizuara, shifër kjo normale dhe që tregon për një trajtim rigoroz të kompanisë kundrejt klientëve.

Puna e bërë nga departamenti vërehet edhe në afatin e mbylljes së rastit të dëmit ndaj klientit që varion në përgjithësi nga 7-të deri ne 10-të ditë pune. Vlen të theksohet edhe marrdhënia që ofrohet ndaj klientit, të cilit në rastet e pretendimeve për shumën e ofruar, ndaj tyre përdoren serviset e kontraktuara për kthimin e mjetit në gjendjen e mëparshme. Rastet e dyshimta apo mënyra përfitimi jepen për investigim tek punonjësit e ngarkuar për këtë qëllim. Programi i ndërtuar nga IT-ja për hedhjen e të gjitha dëmeve të ndodhura është një tjetër hap i mire i bërë nga Drejtoria e Përgjithshme për evidentimin e saktë të dëmeve, që nga regjistrimi i dëmit të ndodhur deri ne likuidimin e tij.

Dëmet për sigurimin “kasko” janë paguar për vitin 2018-të në shumën 153,730,439 lekë. Pothuaj në 90 % të rasteve këto dëme trajtohen në serviset me të cilët janë lidhur edhe kontrata bashkëpunimi. Siç kemi trajtuar me lart sigurimi “kasko” rezulton pa efektivitet gjatë vitit 2018-të dhe për këtë duhet punuar si në drejtim të rishikimit të tarifave të primit të sigurimit ,por edhe të ndjekjes së ecurisë së dëmeve kryesisht me klientë të cilët rezultojnë me dy e më shumë dëme të paguara, për të cilët duhet analizuar marrja në sigurim i tyre apo jo. Hedhja e të dhënave në programin e krijuar bëhet në mënyrë të rregullt si dhe për dëmet tpl.

Dëmet e ardhura nga sigurimi karton jeshil dhe fond kompensimi për vitin 2018-të janë në shumën 324.035.447 lekë. Në këtë shifër të lartë duke patur parasysh pagesat e bëra nga kompania ka nje ndikim kryesor pagesa e bëre ndaj fondit të kompensimit.

Siç edhe shihet pagesa e bërë nga kompania ka një shifer të lartë prej 238.755.456 lekë, e cila perfaqëson dëme të shkaktuara nga individë të pasiguaruar, që kanë shkaktuar dëme ndaj klientëve të siguruar. Këto dëme që paguhen Çdo vit kanë të bëjnë me dëme të ndodhura nga viti 2013-të e këtej ,duke u paguar sipas përqindjes që ka secila kompani në tregun e sigurimeve. Pjesa problematike e kësaj pagese është rimbursimi që duhet të bëjnë shkaktarët e dëmeve, të cilët duhet të paguajnë dëmin e shkaktuar, por që në fakt shkon deri në 5 % të vlerës së dëmit. Pra kjo është një pagesë e rëndë për kompaninë tonë por dhe për kompanitë e tjera të sigurimit.

Departamenti i marinës ka trajtuar e paguar për vitin 2018 –të shumën 4.529.845 lekë dëme, të gjitha këto në zërin e produktit të sigurimit “mall në transport”. Kryesisht janë dëme në shifra të vogla dhe pa probleme shqetësuese për kompaninë.

Aktuaristikë-Statistika. Ka bërë drejt dhe në përputhje me udhëzimet e kriteret e miratuara llogaritjet e rezervave teknike të kompanisë.

Përpara se të paraqiten në departamentin e financës për t’u përfshirë në bilancin financiar, rezervat janë paraqitur konform udhëzimeve pranë Autoritetit Mbikqyrës Financiar ,për të marrë miratimin e llogaritjes së tyre, e njëjta është dërguar edhe në Uniqa Group Austria. Të gjithë tabelat e paraqitura janë miratuar rregullisht. Këto rezerva paraqesin realisht fondet që kompania duhet të disponojë ,në rast të ndodhive të papritura dhe që duhen mbuluar me këto rezerva të vendosura në bilancin financiar të saj.

Të dhënat e raportuara nga statistika për primet e sigurimit janë të gjitha të përputhura me departamentet e marrjes në sigurim, si dhe me departamentin e financës. Ne kemi bërë këtë kontroll dhe nuk ka asnjë diferencë. E njëjta situatë është edhe për dëmet e raportuara dhe ato të paguara. Regjistrat e raportimit mbahen rregullisht Çdo muaj dhe plotësohen sipas modeleve përkatëse të miratuara nga Autoriteti Mbikqyrës Financiar. Sipas rregulloreve të brendshme edhe raportimet në Uniqa Group Austria janë kryer periodikisht bazuar në modelet e dërguara prej tyre.

Departamenti Ligjor. Ka ndjekur me përgjegjësi të gjitha Çështjet gjyqësore që kanë të bëjnë me Sigal Uniqa Group Austria. Kjo si për rastet kur kompania jonë është në rolin e paditësit edhe në rastet kur kompania është e paditur. Rastet si për njërin fakt dhe tjetrin në një përqindje të madhe janë në favor të kompanisë. Një punë në veçanti e mirë është bërë lidhur me dëmet “fond kompensimi”, duke ndjekur Çdo rast të pagesës së tyre shkaktarin e dëmit të krijuar, gjë që ka rritur ndjeshëm shumat e kthimit të vlerës së dëmit. Ka një bashkëpunim të ngushtë me avokatët e të dëmtuarve, duke berë të mundur zgjidhjen e problemit të pagesave të dëmeve pa u drejtuar pranë organeve gjyqësore. Të

gjitha veprimet e bëra nga departamenti legal, hidhen në regjistra ku janë të përcaktuara qartë e saktë gjyqet e mbyllura, ato në vazhdim sipas shkallëve të gjyqësorit dhe dosjet në proces për t'u hapur. Nga Departamenti ligjor ka një bashkëpunim të vlefshëm me departamentet e kompanisë dhe drejtuesit e saj. Kjo edhe në aspektin e përgatitjes së dokumentacionit ligjor që nevojitet në zbatim të detyrave të tyre gjatë punës, konform edhe udhëzimeve të dërguara nga Autoriteti Mbikqyrës Financiar, Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Autoritetit të Konkurrencës e të tjera organizma shtetërore me të cilat lidhet puna në kompaninë tonë. Gjithashtu edhe në aspektin e përgatitjes së urdhrave e udhëzimeve ligjore të nevojshme për ecurinë e punës, të diktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Kompanisë, duke bërë përgatitjen ligjore dhe shpërndarjen e tyre për të gjithë departamentet. Vlen të përmendet puna e bërë në materialet e trajtuara nga ana e bordit të Sigal Uniqa Group Austria, të cilat përpunohen nga departamenti ligjor dhe shpërndahen në departamente. Disa here në muaj për Drejtorin e Përgjithshëm dhe më tej për dejtuesit e departamenteve, përgatiten materialet e mbledhjes dhe publikimit të Autortetit Mbikqyrës Financiar, për njohjen dhe azhornimin e punonjësve me këto materiale.

Departamente e Sektorë të tjerë të Kompanisë. Janë edhe departamente të tjerë që funksionojnë në Kompaninë Sigal Uniqa Group Austria dhe që kanë qenë objekt në kontrollet tona periodike vjetore. I tillë është departamenti i marketingut, i cili për vitin 2018-të ka bërë një punë mjaft voluminoze në drejtim të reklamimit të vlerave të kompanisë, produkteve që shiten, organizime të ndryshme eventesh etj. Të tilla reklama janë bërë Çdo muaj në shtypin e shkruar ,duke batuar në gazetate kryesore në vend produktet e reja te Sigal Uniqa Group Austria, produkte të cilat siç kemi përmendur më sipër blihen on-line nga klientët, produkti miniasco etj. Drejtim tjetër në punën e marketingut është edhe reklamimi në televizionet kryesore të vendit duke pasqyruar vlerat e vërteta të produkteve të sigurimit të kompanisë, dëmet e paguara dhe korrektësia në shërbime etj.

Në të gjitha eventet që organizohen kompania është shfaqur me pjesën e saj të ekspozimit në mënyrë shumë dinjitoze. Janë përgatitur e stampuar të gjitha reklamimet që vendosen kryesisht në mjetet e transportit si autovetura, mikrobuze e autobuzë etj. Të gjitha zyrat kanë pamje të njëjtë në të gjithë territorin ku operon kompania, duke zbatuar korrektësisht udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme. Funksionojnë gjithashtu: faqja zyrtare në web e kompanisë e cila rinovohet periodikisht, një radio e brendshme me qëllime informimi për produktet e sigurimit, por edhe kulturore.

Departamenti i IT-së me të dy sektorët e tij të programimit dhe mirëmbajtjes kanë funksionuar rregullisht. Janë hartuar e instaluar programe kompjuterike me vlera për kompaninë si: programi i regjistrimit të dëmeve, programi i blerjeve on-line të produkteve të sigurimit, programi i shitjeve on-line të policave nga punonjësit e agjentët i cili është vendosur më përpara por janë bërë përmirësime cilësore. Mirëmbajtja e rrjetit si në drejtori dhe në degë është në gjendje optimale. Në Çdo rast defektesh apo anomalie ka asistencë të menjëhershme, po kështu për zëvendësime të paisjeve të konsumuara.

Sektori i administratës e personelit gjithashtu funksionon normalisht. Pasqyrohen nëpërmjet shkresave të rregullta të firmosura nga drejtuesit të gjitha lëvizjet e mundshme të personelit apo ardhjes së elementëve të rinj në kompani. Mbahen rregullisht kontratat e punës si me punonjësit dhe agjentët e kompanisë, dhe Çdo muaj të gjithë drejtorëve të departamenteve u dërgohet lista e agjentëve e azhornuar. Edhe zyrat që disponon kompania me qera për rrjetin e shitjeve në të gjithë Shqipërinë ,kanë kontrata të rregullta dhe ndiqet Çdo ndryshim i mundshëm.

Zyra e administrimit të policave të sigurimit, ndjek në Çdo moment si anën e prodhimit të të gjitha llojeve të policave të sigurimit që kompania lëshon në tregun e sigurimeve, kjo sipas nevojave dhe kërkesave të secilit departament, por edhe shitjen e tyre dhe si përfundim gjendjen e secilit agjent të numrit të policave të sigurimit që disponon në Çdo kohë. Kjo zyrë bën blerjen dhe shpërndarjen e materialeve të kancelarisë,për nevoja të departamenteve të kompanisë.

Zyra e arkivit të kompanisë ,në udhëzimet e fundit të drejtuesve është krijuar me ambiente të reja e bashkëkohore, duke sistemuar të gjithë dokumentacionin në vite që nga krijimi i kompanisë sipas departamenteve përkatëse.

Departamenti i Financës. Nga ana e departamentit të kontrollit në vazhdimësi gjatë vitit shohim e kontrollojmë punën e bërë në departamentin e financës. Ne vërejmë se është punuar mirë. Është zbatuar me korrektësi plani unik kontabël i miratuar, dhe të gjitha veprimet janë hedhur në llogaritë respektive bazuar në këtë plan kontabël. Si rrjedhojë të gjitha llogaritë që dalin në fund të vitit në bilancin kontabël, janë me saldo të rregullta. Janë vendosur dhe zbatohen standardet ndërkombëtare financiare të raportimeve SNRF në të gjitha pasqyrat e bilancit kontabël.

Në zbatim të Ligjit nr.9917, datë 19.05.2008, ndryshuar me ligjin nr.66/2012 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, dhe udhëzimit nr.28 datë 31.12.2012 “Për metodat dhe procedurat e raportimit dhe marrjes së masave parandaluese nga subjektet”, është bërë një punë e kujdesshme në vazhdimësi gjatë vitit 2018-të. Kjo zyrë bashkëpunon ngushtë me departamentin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Uniqa Group në Austri.

Uniqa Group Austria vazhdon të organizojë seminare e trajnime disa herë në vit, duke mbledhur punonjësit të cilët merren me problemet e parandalimit të pastrimit të parave, nga të gjitha vendet ku Uniqa Group Austria shtrin veprimtarinë e saj të sigurimit. Në këtë linjë pune edhe Sigal Uniqa Group Austria organizon trajnime me punonjësit e saj.

Në kompani bëhet një punë e mirë edhe për sa i përket rrezikut financiar. Mbledhja herë pas here e një këshilli administrativ për këtë qëllim nga Drejtori Përgjithshëm, ka krijuar efekte stabiliteti pozitive, për situatat që kalohen në këtë drejtim. Të tilla situata mund të përmendim:

- Rreziku i tregut. Meqënëse kompania punon në te tre monedhat lekë, euro dhe usd dhe duke ruajtur proporcione të drejta ,kundrejt arkëttimeve dhe më tej pagesave, ka krijuar një balancë të drejtë ,duke shmangur rrezikun e monedhës nga kurset e këmbimit.

- Ndaj rrezikut të valutës është vepruar me shpejtësi dhe në koherencë me ngjarjet e luhatjeve të tyre. Është ndërhyrë herë pas here në këmbimin e tyre në lekë dhe anasjelltas duke krijuar jo vetëm stabilitet por edhe efekte pozitive.

- Bëhen vazhdimisht raportet e sigurimeve që realizon kompania në lekë, euro e usd ,duke vepruar drejt dhe duke nxjerrë analizat përkatëse në këtë drejtim.

- Rreziku i normave të interesave në banka nuk përbën problem për kompaninë, pasi depozitat janë afatgjata dhe marrdhëniet me bankat në nivel të mirë duke marrë edhe interesa preferenciale.

- Kompania nuk ka marrë asnjëherë kredi në banka, të gjitha lëvizjet përballohen me mjetet e saj dhe si pasojë nuk është e ekspozuar ndaj rreziqeve të tilla.

- I gjithë legjislacioni në fuqi tashmë është i qëndrueshëm dhe Çdo ndryshim eventual që bëhet, kompania merr masat paraprake dhe nuk ka asnjë ndikim në ecurinë ekonomike e financiare të saj.

Në përfundim të raportit të kontrollit, ne si departament mendojmë se Kompania Sigal Uniqa Group Austria, ka një gjendje të qëndrueshme financiare dhe garanton një ecuri të mirë të aktivitetit të sigurimeve në vazhdimësi. Për të përmirësuar të dhënat e saj në të ardhmen krahasuar me vitin 2018-të, duke patur parasysh realizimin e një të ardhure neto (fitimi) modest në këtë vit ,vëmendja duhet të përqëndrohet kryesisht në uljen e shpenzimeve të aktivitetit.Pasi siç edhe u konstatua në pasqyrat që dhamë më sipër, shpenzimet kanë qenë në disa elemente të tyre më të larta. Zërat kryesorë ku mendohet që ka vend për përmirësim janë kryesisht shpenzimet e karburantit, shpenzimet për reklama, dëmet e paguara etj. Në rezultat duke qenë një shifër e konsiderueshme ka ndikuar edhe shpërblymi për menaxhmentin për vitet 2016-të dhe 2017-të.

Ne në vazhdimësi në zbatim të programit të punës të miratuar per vitin 2019-të do të ndjekim e kontrollojmë punën e bërë dhe për Çdo ecuri jo normale apo anomali do të jemi korrektë në komunikim me ju.

Në vazhdimësi të kontrolleve të bëra nga departamenti ynë në Shoqërinë Sigal Life Uniqa Group Austria, po ju paraqesim Raportin e Kontrollit të hartuar për ecurinë në fushën e sigurimit të jetës dhe atë financiare gjatë vitit 2018-të

Marrja në Sigurim. Kompania Sigal Life Uniqa Group Austria operon në tregun e sigurimit të jetës, me policat e lëshuara për “sigurimi jetës së debitorit”.Duke përgatitur për klientët e saj 7-të lloje të

ndryshme policash ,në përputhje me kërkesat e tregut e të klientëve për siguri në jetë debitori, PPIA-1, PPIA-2, Mortgage, micro me kolateral dhe pa kolateral, SE dhe Micro. Po kështu lëshohen edhe policat e sigurimit të jetës në grup, të kombinuar dhe të jetës me kursim. Realizimi i primeve në masën më të madhe bëhet nga bashkëpunimi i kompanisë me bankat e nivelit të dytë, të cilat operojnë në Shqipëri. Rastet e tjera të marrjes në sigurim kanë të bëjnë me marrjet në sigurim të firmave e kompanive, për punonjësit e tyre dhe të organizmave shtetërore, vetëm dhe bashkësigurim me kompanitë që operojnë në tregun e sigurimeve. Marrdhëniet e krijuara mes departamentit të marrjes në sigurim dhe bankave respektive, kanë qenë të rregullta dhe të sakta për Çdo rast marrje në sigurim. E njëjta edhe për rastet e marrjes në sigurim të shoqërive e organizmave shtetërore. Policat e sigurimit me afate shumë vjeçare janë rinovuar në kohë dhe ato të lidhura me klientë të rinj sipas afateve të vendosura. Kontratat e sigurimit të lidhura nga Kompania Sigal Life Uniqa Group Austria ,bëjnë të mundur vetvetiu ekspozimin e kompanisë ndaj rrezikut të sigurimit. Por, masat e marra nga drejtuesit e kompanisë kanë bërë të mundur ,uljen e këtij rreziku në minimumet e tij dhe gjendja e saj ekonomike të mos ketë luhajtje e probleme të paparashikuara. Disa drejtime të punës në këtë kendvështrim janë:

- Krijimi i një grupi këshillimi në kompani për të ndjekur herë pas here politika për uljen e rrezikut të sigurimit.
- Në rastet me rrezikshmëri të lartë dhe të paparashikueshme, vendimi për lidhjen e kontratave të risigurimit me partnerë të besueshëm qoftë me Uniqa Group Austri edhe partnerë të tjerë, gjë që bën të mundur uljen në maksimum të rrezikut.
- Rastet e dyshimta dhe me risk duke bërë të mundur kryerjen e analizave mjekësore të klientit në organe të specializuara, në të kundërt duke mos e marrë në sigurim.
- Numri i madh i klientëve të marrë në sigurim dhe shumëllojshmëria e tyre e ul ndjeshëm rrezikun eventual.
- Kriteret e qarta dhe të mirëpërcaktuara në policat e sigurimit një element në favor të marrjes në sigurim.
- Llogaritjet dhe testet e bëra në vazhdimësi kanë përcaktuar drejt rastet se kur mund të dëmtohet kompania.

Të gjitha këto kanë bërë që gjatë vitit 2018-të dhe në vazhdimësi, kompanisë të mos i paraqiten raste të ekspozimit ndaj këtyre rreziqeve të marrjes në sigurim, por të ketë një veprimtari normale të saj. Në punën që bëhet në departamentin e marrjes në sigurim, është mirëkoordinuar puna edhe me urdhrat e udhëzimet që vijnë herë pas here nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, si dhe Autoriteti Mbikqyrës Financiar. Në zbatim të vendimeve dhe udhëzimeve të ardhura, punonjësit e ngarkuar ndjekin me përparësi të gjithë të siguruarit të cilët janë pjesë e këtyre udhëzimeve duke marrë edhe dokumentacionin e nevojshëm prej tyre. Në fund të muajit përgatiten edhe listat e të siguruarve të cilët i përfshin vendimi apo udhëzimi dhe dërgohen në organet përkatëse për verifikim. Për këtë qëllim bëhen edhe trajnime e kualifikime me personelin përkatës. Në këtë drejtim themi që punohet mirë dhe zbatohen me përpikmëri detyrat e lëna nga kontrollet e ushtruara nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Autoriteti Mbikqyrës Financiar.

Aktuaristikë – Statistika. Në llogaritjet e rezervave janë përdorur metodat e njohura e miratuara aktuariale, po kështu edhe për rezervat matematikore janë llogaritur sipas standardeve të miratuara. Pra janë llogaritur drejt të gjitha shumatat e duhura, për rastet e rreziqeve që mund t'i ndodhin kompanisë në të ardhmen. E njëjta situatë është edhe për rezervat për dëmet. Janë llogaritur vlerat për dëmet e ndodhura por të papaguara si dhe janë vlerësuar dëmet e ndodhura por të pavlerësuar. Të gjitha llogaritjet e bëra për rezervat e kompanisë, me pasqyrat përkatëse janë dërguar pranë Autoritetit Mbikqyrës Financiar duke marrë miratimin përkatës konform udhëzimeve.

Spektori i mbajtjes dhe raportimit statistikor, ka hedhur rregullisht Çdo muaj të dhënat sipas policave të shitura konform urdhrave e udhëzimeve të miratuara dhe dërguara nga Autoriteti Mbikqyrës Financiar dhe gjithashtu, në përputhje me kërkesat e Uniqa Group Austria. Të gjitha të dhënat e hedhura rakordojnë me departamentin e marrjes në sigurim dhe departamentin e financës. Regjistrat mbahen

në të tri monedhat në të cilat lëshohet polica e sigurimit, në lekë, euro dhe usd. Në regjistër shënohet edhe vlera e konvertuar në lekë me kursin mujor marrë nga banka.

Dëmet e ndodhura e të paguara-Komisionet e agentëve. Për Çdo dëm të ndodhur, sipas llojit të sigurimit në Çdo rast është hapur dosja e dëmit. Kjo dosje përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar, sipas udhëzimeve të lëshuara nga Drejtoria për këtë qëllim. Nuk ka asnjë dosje me të meta e dobësi. Llogaritjet janë bërë konform rregulloreve të lëshuara për këtë qëllim, si për rastet me vdekje dhe ato për sëmundje e aksidente. Të gjitha vlerat e llogaritura janë ballafaquar me bankën, e cila ka lëshuar policën e sigurimit dhe nuk ka diferenca apo mosdakortësi në këtë drejtim. E njëjta situatë është edhe për dëmet e ndodhura në rastet e sigurimit të punonjësve ,të firmave e kompanive të ndryshme. Shumat e paguara janë firmosur nga personi përgjegjës në këtë detyrë dhe Drejtori I Përgjithshëm. Me tej është bërë pagesa me kalim në llogari nepërmjet bankës.

Departamenti i Financës. Mbajtja e kontabilitetit është bërë konform planit unik kontabël të miratuar. Gjithashtu përgatitja e pasqyrave financiare, është bërë konform standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar SNRF. Kjo bën të mundur për një gjykim dhe vlerësim të drejt të gjendjes financiare të kompanisë, si gjatë periudhave ushtrimore dhe në fund të vitit financiar. Llogaritë janë prekur drejt dhe pasqyrojnë saktë aktivitetin financiar të kompanisë, në mbylljen e bilancit financiar në fund të vitit. Në këtë raport kontrolli përgatitur nga ana jonë ,konstatojmë se nga ana e departamenteve të Sigal Life Uniqa Group Austria është punuar mirë e saktë. Të dhënat e pasqyruara paraqesin gjendjen reale të kompanisë. Bilanci Financiar ,pasqyron në mënyrë të vërtetë rezultatin financiar të kompanisë dhe gjendjet e llogarive të saj me date 31 dhjetor 2018. Nga Departamenti i Kontrollit në vazhdimësi do të shohim punën e kompanisë dhe ecurinë e saj dhe do të informojmë në Çdo moment nëse do të ketë probleme apo të meta në punën e saj.

DEPARTAMENTI I KONTROLLIT

RAPORT PËR VLERËSIMIN E RREZIQEVE.

Përmbledhje

Përshkrim i provës së rreziqeve të sigurimit dhe rreziqeve të shpenzimeve në sigurimet e jo -jetës.

KUADRI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT

Kompania ka ngritur strukturat përkatëse përgjegjëse, të krijuara për të ushtruar funksionin e administrimit të rrezikut me qëllim vlerësimin, pranimin dhe administrimin e rrezikut. Këto struktura janë:

- *Bordi I Drejtorëve që përbëhet nga Drejtori I Përgjithshëm, Zv Drejtori I Përgjithshëm, Drejtori i Departamentit të Marrjes në Sigurim*
- *Risk Menaxher Responsible person*
- *Compliance*

KATEGORITË E RREZIQEVE

2.1 Rreziqet e sigurimit

Rritje e UPR.

Rritje e RBNS

Rritje e dëmeve të paguara.

2.2 Rreziqet financiare

Rritje e shpenzimeve operative të Kompanisë për arsye të ndryshme.

KUADRI I RAPORTIMIT

Metodologjia e miratuar për vlerësimin dhe klasifikimin e rreziqeve dhe kryerjen e provave të rezistencës është:

Llogaritja e nevojave për kapital shtesë në rast se gjatë vitit të ardhshëm, ndodhin të gjithë skenarët e menduar të situatave katastrofike, epidemike dhe të krizave financiare.

Llogaritjet janë berë mbi bazë skenari.

Më poshtë tregohet si janë zgjedhur skenarët e mundshëm të rrezikut.

RREZIQET DHE ADMINISTRIMI I KAPITALIT

4.1 Rreziqet e sigurimeve

Skenari 1: Është supozuar që gjatë vitit të ardhshëm do të ketë një rritje të ndjeshme të frekuencës së dëmeve dhe inflacionit të dëmeve. Të dy këta faktorë do të prekin të gjithë portofolin (të gjitha LoB). Mendohet që një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 50-të vjet (probabilitet 2%). Ndikimi do të jetë:

Rritje e UPR.

Rritje e RBNS

Skenari 2: Një katastrofë natyrore që dëmton masivisht pronat e siguruara. LoB I prekur do të jetë portofoli I Zjarrit. Mendohet që do të kemi 2 -fishin e numrit të dëmeve të paguara dhe rritje me 50% të dëmit mesatar. Një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Ndikimi do të jetë:

Rritje e dëmeve të paguara për portofolin e Zjarrit.

Skenari 3: Nje krizë financiare që sjell mosplotësimin masiv të kontratatave. Portofoli I prekur do të jetë portofoli I garancive (ofertë + kontratë). Mendohet që do të paguhen dëme për 2% të të gjitha kontratatave në fuqi, me rritje 10% të dëmit mesatar. Një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 100

vjet (probabilitet 1%). Ndikimi do të jetë:

Rritje e dëmeve të paguara për portofolin e Garancive.

Skenari 4: Epidemi masive që sjell sëmundshmëri në nivele të larta. Portofoli I prekur do të jetë Shëndeti. Mendohet që do të paguhen dëme për 70% të të gjitha kontratatave në fuqi, me rritje 50% të dëmit mesatar. Një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Ndikimi do të jetë:

Rritje e dëmeve të paguara për portofolin e Shëndetit.

Skenari 5: Në krizë financiare që sjell mosplotësimin masiv të kontratatave. Portofoli I prekur do të jetë portofoli I Mallit në Transport. Mendohet që do të paguhen dëme për 15% të të gjitha kontratatave në fuqi (ose 1.5 fishin e numrit të dëmeve të paguara), me 50% rritje të dëmit mesatar. Një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Ndikimi do të jetë:

Rritje e dëmeve të paguara për portofolin e Mallit në Transport.

4.2 Rreziqet financiare

Skenari 6: Rritje me 10% e shpenzimeve operative të Kompanisë për arsye të ndryshme. Kjo nuk përfshihet në Rreziqet e Sigurimit.

4.3 Kërkesat për kapital për një rritje të rezervave për primin e pafitur (KKupr) (Skenari 1)

Ne këtë rezervë ka 2 rreziqe: Rreziku Parametrik (Parameter) dhe Rreziku I luhatjes (volatility).

4.3.1 Rreziku parametrik

Periudha mesatare e rrezikut të mbetur është marrë 6-të muaj. Frekuenca e dëmeve është menduar se do të rritet me 10% në vit dhe inflacioni i dëmeve do të rritet me 2% në vit.

Kërkesa për kapital për efekt të rrezikut parametrik llogaritet:

$$KKpar = (f + i) \times \frac{6}{12} \times UPR \quad (1)$$

f= frekuenca

i= inflacioni

4.3.2 Rreziku I luhatjes (volatility)

Rreziku I luhatjes, paraqet pasigurinë mbi ecurinë e biznesit për periudhën për të cilën është mbajtur rezerva UPR.

Kërkesat për kapital për rrezikun e luhatshmërisë llogaritet:

$$KKvol = 2.58 \times \sqrt{\frac{n}{2}} \times m \times \sqrt{1 + v^2} \quad (2)$$

n= numri I pritshëm i dëmeve për vitin e ardhshëm

m= dëmi mesatar i pritshëm për vitin e ardhshëm

v= koeficienti i variacionit të shpërndarjes së dëmeve për vitin e ardhshëm

Kërkesa për kapital për rritje te UPR si pasojë e 2 rreziqeve te mësipërme është:

$$KKupr = \sqrt{KKpar^2 + KKvol^2} \quad (3)$$

Kërkesat për kapital për rritje të rezervave (KKrez)

Për rezervat, faktorët e rrezikut janë dëmi mesatar, inflacioni i dëmeve dhe historiku I pagesave.

Nëpërmjet llogaritjes së devijimit standard (S) synohet të matet UNCERTAINTY.

Për një LoB, devijimi standard llogaritet si më poshtë:

$$Slob = \max [1 - 2 \times c; 0.7 \times (1 - c)] \times \min \left(u \times \frac{\sigma}{\sqrt{a}}; 0.5 \times f \right) \quad (4)$$

c= pjesa e ceduar në risigurim (llogaritet si raporti ndërmjet shpenzimeve të risigurimit me primet e shkruara.

u= dëmet e paguara

σ = devijimi standard

a= pjesa e LoB brenda kompanisë. Llogaritet si raporti i primeve të LoB me primet e kompanisë

f = rezervat për dëmet pezull

p_kom = primet e kompanisë

P_lob = primet e LoB

Totali për Kompaninë:

$$S = \sqrt{\sum Slob^2} \quad (5)$$

Kërkesat për kapital llogariten:

$$KKrez = 2.58 \times S \quad (6)$$

Kërkesat për kapital për rrezikun e katastrofave (KKkat) (Skenari 2 – 5)

Kërkesat për kapital llogariten:

$$KKkat = \sqrt{\sum_{i=1}^4 kat_i^2} \quad (7)$$

Nevojat e përgjithshme për kapital për rrezikun e sigurimit janë:

$$KKins = \sqrt{KKrez^2 + KKupr^2 + 2 \times 0.5 \times KKrez \times KKupr + KKkat^2} \quad (8)$$

Kërkesat për kapital për rrezikun e shpenzimeve (KKexp) (Skenari 6)

Qëllimi është që të provohet rreziku i rritjes së shpenzimeve, për arsye të ndryshme me 8%.

Mendohet që një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 50-të vjet (probabilitet 2%).

$$KKexp = 0.08 \times SHP \quad (9)$$

PLANET E VIJUESHMËRISË SË VEPRIMTARISË DHE PERBALLIMIT TË SITUATAVE TË PAPANASHIKUARA

Për të siguruar vijueshmërinë e veprimtarisë, për të përballuar situatat e parashikuara më sipër, për të rifilluar veprimtarinë pasi rreziqet e mësipërme të jenë materializuar apo ngjarjet me efekt

të dëmshëm të kenë ndodhur, Kompania ka marrë masat për sigurimin e kapitalit shtesë që do të nevojitet për këtë qëllim.

Rezultatet e testimeve janë si më poshtë:

Kërkesa për Kapital shtesë është:

			EURO
1	KKupr		609,376
1.1		KKpar	564,951
1.2		KKvol	228,406
2	KKrez		6,110,484
3	KKkat		494,190
3.1		KKkat1	440,623
3.2		KKkat2	0
3.3		KKkat3	181,770
4.3		KKkat4	130,516
	KKins		6,455,785
4	KKexp		1,034,921
	KKtotal		7,490,706

REKOMANDIMET DHE MASAT

Strukturat përkatëse përgjegjëse, të krijuara për të ushtruar funksionin e administrimit të rrezikut me qëllim vlerësimin, pranimin dhe administrimin e rrezikut, raportojnë periodikisht për rreziqe me vlerë të madhe, që mund të ndikojnë në aktivitetin e ardhshëm të kompanisë.

PERFUNDIMI

I marrë veçmas, secili skenar mund të ndodhë 1 herë në 50-të vjet (probabilitet 2%) ose 1 herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Në përgjithësi, probabiliteti që të ndodhin të gjithë skenarët brenda vitit të ardhshëm, është shumë i vogël (i papërfillshëm). Kompania ka marrë masat për sigurimin e kapitalit shtesë që do të nevojitet për këtë qëllim.

OBJEKTIVAT / Forecast 2019

Produktet e sigurimit Type of insurance	Grupi Group (EUR)	AL (ALL)	KS (EUR)	MK (DEN)
PASURIA Property	13,954,034	1,183,251,000	1,821,600	169,219,000
1 Zjarri / Fire	8,256,743	663,000,000	669,600	143,338,000
2 G. Kontrate / Contract Guarantee	694,469	76,500,000	88,000	
3 G. Oferte / Offer Guarantee	65,345	4,080,000	33,000	
4 CAR	1,470,595	163,200,000	88,000	5,460,000
5 Pergjegjesi / Liability	2,381,353	204,000,000	432,000	20,421,000
6 Banka CIS-CIT	1,060,124	72,420,000	486,000	
7 Bujqesi & Blegtori / Farming insurance	25,404	51,000	25,000	
MOTORIKET E DETYRUESHME MTPL	30,909,587	2,217,000,000	5,982,650	452,027,000
1 TPL	24,352,059	1,710,000,000	5,182,650	345,146,000
2 Kufitare	1,647,884	102,000,000	800,000	2,414,000
3 K. Jeshil	4,909,645	405,000,000		104,467,000
MOTORIKET VULLNETARE Voluntary Motor Insurance	3,285,151	180,000,000	1,016,500	51,754,000
1 Kasko / CASCO	3,285,151	180,000,000	1,016,500	51,754,000
SHENDETI Health	6,699,544	396,500,000	2,273,450	78,877,000
1 Shen. Udhetim / Travel insurance	1,090,726	70,000,000	234,600	18,520,000
2 Shendet Privat / Private health	4,178,850	280,000,000	1,909,200	3,068,000
3 Aks. Personale / Personal Accident	1,429,968	46,500,000	129,650	57,289,000
MARINA E AVIACIONI Marine and Aviation	1,485,111	154,000,000	107,000	9,669,000
1 H & M	71,349	9,000,000	0	
2 P & I	79,277	10,000,000	0	
3 Mall Transport / Cargo	517,931	32,000,000	107,000	9,669,000
4 Avione / Aviation insurance	816,553	103,000,000	0	
TOTAL SIGAL JO-JETA TOTAL SIGAL NON LIFE	56,333,428	4,130,751,000	11,201,200	761,546,000
1 Life Regular Premium	6,955,087	448,153,000	1,080,700	142,753,000
2 Life Single Premium	2,058,884	257,088,000	0	1,277,000
TOTAL JETA TOTAL LIFE INSURANCE	9,013,971	705,241,000	1,080,700	144,030,000
SHAFF	0	0	0	0


WE ARE SIGAL UNIQA

WE are the leading insurance company in the Albania, where we lead the insurance market since 2002, having an average of 30% of the market.


SIGAL UNIQA Group is a large family with over 1500 employees and agents serving 1 million customers in three countries: Albania, Kosovo and North Macedonia.

SIGAL UNIQA is one of the largest financial groups in the region, consisting of 7 insurance companies and 1 private pension fund and owns 121.2 million Euros of assets, counts over 65 million Euro written premiums for 2018 and about 300 million Euros paid damages among years.


Premium Volume (Euro)




No. o Offices



No. of Contracts



Employees and Agents



Dear readers,

For SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Annual Report 2018 is like a financial DNA test. It is our visionary, strategic and financial foundation. A cornerstone of the past and a bridge to the future. This is an accountable report for our shareholders and strategic partners. All our energy and dedication is in our forward-looking plans in the 2019s. A promising future that will be even more interesting for our industry than the year left behind, especially because we are all involved in the complexity and speed of the changes that surround us and are becoming ever greater than ever before.

I and my colleagues from the SIGAL UNIQA group management board belong to a generation who had more time in her youth to make projections and long-term plans for the 30 or 40 years that would come where things were still very traditional, using fixed ways of thinking and approaching the phenomena surrounding our lives and affairs. But nowadays, this option does not exist anymore because we not only have to be visionaries for the next 30 or 40 years, but we must be absolutely visionary for every 5 year old wandering around us because the pace of life and change today is this. In order to keep the speed that is being dictated by us day by day, information technology and digital transformation has capillaryly affected all the methods of doing business and doing business by turning the way of working.

